

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

FABRIKA E AMBALAZHIMIT TË UJIT
“ANAHITA” SH.P.K. KOMUNA ISTOG

“ANAHITA”
SH.P.K.



**RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS
PËR IMPIANTIN E AMBALAZHIMIT TË UJIT "ANAHITA"
SH.P.K. KOMUNA ISTOG**

"ANAHITA" SH.P.K.



Aplikuesi:

Hartuesi i raportit:

"ANAHITA" SH.P.K.

GEOSOURCE CONSULTING SH.P.K.

Prishtinë, Shkurt 2024



RAPORTI I VLERSIMIT TE NDIKIMIR NE MJEDIS
PËR KOMPANINË E AMBALAZHIMIT TË UJIT "ANAHITA" SH.P.K.
KOMUNA ISTOG
NË NGASTRAT KADASTRALE NR:
P-70806057-00875-0 CERRCË

Investitori: "Anahita" Sh.P.K.
Aplikuesi: Besart Shatri
Adresa: Rr. 8 Maji, Nr. 14, Kashicë, K.
Istog
E-mail: besarttshatri@gmail.com
Mob.: +383 045 663594

Hartuesi i raportit:
Konsorcimi: Geosource Consulting" Sh.p.k.
Prishtinë
Email: astrit-shala@hotmail.com
Tel: 044800098
Adresa: Prishtinë

Hartuesit;

1. Dr.sc. **Astrit Shala**

2. Ing. Dipl. **Masar Kabashi**, Arch

3. MSc. **Iliriana Sutaj**, Ndërtimtarisë

Prishtinë, Shkurt 2024



Contents

1. HYRJA	6
2. KUADRI LIGJORE PËR HARTIMINE RAPORTIT TE VNM-S	8
2.1. Legjislacioni	8
2.3. Metodologjia e punës	10
2.3. Qëllimi i hartimit të VNM-së.....	11
3. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT DHE MJEDISIT.....	13
3.1. Pozita gjeografike e impiantit.....	13
3.2. Popullata dhe vendbanimet	16
3.3. Lidhjet e Komunikacionit	17
3.4. Kushtet klimatike	17
3.5. Natyra dhe biodiversiteti.....	18
3.6. Flora dhe Fauna.....	19
3.7. Peizazhi.....	20
3.8. Ajri.....	21
3.9. Karakteristikat hidrologjike.....	21
3.9.1. Lumenjtë dhe Burimet.....	22
3.9.2. Ujërat nëntokësore	23
3.9.3. Ujërat termo-minerale	23
3.10. Karakteristikat Gjeologjike dhe Hidrogeologjike të Zonës	24
3.10.1. Karakteristikat Gjeologjike të Rajonit.....	24
3.10.2. Sedimentët Liqenore – Lumore (JQ),.....	25
3.10.3. Depozitimet Proluviale (Pr).....	25
3.10.4. Depozitimet Aluviale (Al).....	25
3.11. Karakteristikat Hidrogeologjike.....	27
3.11.1. Akuiferet dhe llojet e tyre	27
3.11.2. Akuiferi në depozitimet aluviale	27
3.11.3. Akuiferi në depozitimet proluviale	27
3.11.4. Hulumtimi i ujërave nëntokësor	27
3.11.5. Karakteristikat hidraulike të zonës.....	29
3.11.6. Karakteristikat sizmike.....	29
4. PËRSHKRIMI I INFRASTRUKTURA DHE PROCESIT TEKNOLOGJIK.....	30



4.1. Procesi teknologjik i prodhimit.....	30
4.2.Kapaciteti i objektit dhe krahasimi i tij me objektet e tjera	40
4.3. Llogaritja e sasisë se nevojshme te ujit për prodhim dhe nevoja tjera te kompanisë ..	42
4.4. Llogaritja e sasisë se ujit për ambalazhim dhe mbushtore.....	43
4.5. Sasia maksimale e shfrytëzimit te ujit për administratë.....	44
4.6. Karakteristikat e objektit ku do te vendoset linja e fabrikës se ujit.....	45
5. NDIKIMET NE MJEDIS	47
5.1.1. Ndikimet në mjedis - gjatë operimit.....	48
5.2. Ndikimet në ajër	48
5.3. Ndikimet në ujë	48
5.4. Ndikimet në tokë.....	49
5.5. Ndikimet e zhurmës ne mjedis	49
5.6. Ndikimet në florë dhe faunë	50
5.7. Ndikimet në mikroklimë.....	50
5.8. Ndikimet në peizazh	51
5.9. Ndikimet në mjedis pas fazës të mbylljes.....	51
6. MASAT PËR ZBUTJEN E NDIKIMEVE NË MJEDIS	52
6.1. Masat për mbrojtjen e ajrit	53
6. 2. Masat për mbrojtjen e ujit	54
6. 3. Masat për mbrojtjen e tokës.....	55
6. 4. Masat për mbrojtjen nga zhurma.....	55
6. 5. Masat për mbrojtjen e florës dhe faunës	56
6.6. Rastet aksidentale.....	56
7. MONITORIMI I MJEDISIT	57
8. RAPORTIM.....	57
9. MASAT REHABILITUESE PAS PËRFUNDIMIT TË AKTIVITETIT.....	58
9.1. Objektivat e rikultivimit.....	58
9.1.1. Qëllimi i Rikultivimit.....	59
9.1.2. Struktura përfundimtare e sipërfaqeve.....	60
10. PËRFUNDIMI.....	63
Referenca	64
Shtojca.....	64



Table of Figure:

Figura 1. Komuna e Istogut shtrihet në pjesën veriore të rrafshit të Dukagjinit.....	14
Figura 2. Foto lokacioni i fabrikës.....	15
Figura 3. Foto te objektit te ndërtuar.....	15
Figura 4. Lokacioni i fabrikës dhe distanca me shtëpitë.....	16
Figura 5. Distanca ne mese te lokacionit dhe lumit.	24
Figura 6. Harta gjeologjike e terrenit.....	26
Figura 7 Pasqyra e lirë të ujërave nëntokësor në zonë Istogut	28
Figura 8. Forma e shishëve.	30
Figura 9. Ilustrim - modeli i makinerisë e cila do te prodhoj format e shisheve.....	31
Figura 10. Fotografia është vetëm për qëllime ilustrimi dhe nuk përputhet me kusht me makinën e dhënë.	32
Figura 11. Makinaria Shpëlarje – Mbushje – Mbyllje.....	34
Figura 12. Makina e kapakut.	35
Figura 13. Makina e etiketimit.....	36
Figura 14. Koduesi i datës Laserët.....	37
Figura 15. Makinë mbështjellëse me shtrirje.	38
Figura 16. Fotografia është vetëm për qëllime ilustrimi.....	39
Figura 17. Model - Transportuesi i Shisheve.....	40
Figura 18. Ortofoto dhe harta topografike e pikës se kyçjes ne burim.....	43
Figura 19. Skema e procesit teknologjik.....	45
Figura 20. Skica e objektit.....	46
Figura 21. Foto e objektit te ndërtuar.	46
Figura 23. Skema teknologjike e ujerave.....	54
Figura 24. Shema e distancës se mbjelljes.....	62

Tabela:

Tabela 1. Të dhënat Statistike - Mujore për Klimën	18
Tabela 2. Temperaturat Mesatare, Sipas Stinëve të Vitit.....	18
Tabela 3. Kapacitetet e pjesëve ndihmëse në varësi të specifikave të vendit (lartësia, temperatura, lagështia etj.)	32
Tabela 4. Cilësia e ujit të ftohjes dhe qarqeve të shpërndarjes.....	33
Tabela 5. kapaciteti i paketimit te shisheve për minuta.	37
Tabela 6. Te dhënat e makinë klasike automatike paletizuese dhe mbështjellëse.....	38
Tabela 7. Makineri dhe pajisje 8C2 0,5 lt Lista e pajisjeve të linjës.....	41
Tabela 8. Lista e pajisjeve të linjës 2c10 5 lt.....	41
Tabela 9. 0,33-0,75 linja e çmimeve dhe lista e pajisjeve të shisheve të qelqit të gazuar.....	42
Tabela 10. Pasqyrë tabelore e nivelit të zhurmës në varshmëri nga distanca	50
Tabela 11. Paraqitja tabelore e masave teknike dhe organizative	52



1. HYRJA

Kompania "ANAHITA" SH.P.K. është themeluar me seli në Komunën e Istogut në bazë të ligjeve të aplikueshme në Kosovë dhe në bazë të rregullores për regjistrimin e bizneseve afariste me numër të biznesit 811909582 e cila ka planifikuar një veprimtari të mirë për mbushjen dhe ambalazhimin e ujit në shishe me kualitet të lartë. Rezultatet afariste janë mjaftë të suksesshme në lëmin e ambalazhimit të ujit të pijes për arsye të rritjes së kërkesës së madhe edhe në vendet e rajonit dhe në Evropë e po ashtu edhe jashtë sajë. Rritja e kapaciteteve dhe e efektivitetit në afarizmit të ambalazhimit të ujit do të mundësojë që kompania të bëjë rritjen graduale të fuqisë punëtore të biznesit e cila sadopak do të ndikojë në zvogëlimin e papunësisë në komunën e Istogut.

Duke e pasur parasysh që duhet të respektohen dhe përmbushen të gjitha obligimet ligjore që dalin nga ligji për vlerësimin e ndikimit në mjedis, kompania ka iniciuar procedurat për marrjen e Pëlqimit Mjedisor, meqë rast ka kontraktuar: "Geosource Consulting" Sh.p.k. Prishtinë, për hartimin e Raportin të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis/VNM.

Raporti i VNM-së paraqet një dokument të rëndësishëm dhe të domosdoshëm për marrjen e pëlqimit mjedisor, me qëllim që të implementohet impianti për Ambalazhimit të ujit "ANAHITA" SH.P.K., në Z.K. Cerrcë, Komuna e Istogut në ngastrat kadastrale nr: P-70806057-00875-0, e cila parcelë ka 16565.0m². Objekti ku do të montohet fabrika e ujit tani me është i ndërtuar dhe ka leje ndërtimore nga komuna e Istogut.

Me këtë synohet që të identifikohen dhe analizohen ndikimet në mjedis të tërë veprimtarisë së impiantit duke i parashtruar dhe ndërmarr masat e domosdoshme për mbrojtjen e mjedisit në lokacionin ku do të ushtrohet kjo veprimtari.

Duke analizuar karakteristikat e gjendjes ekzistuese të mjedisit në lokacionin ku do të zhvillohet ky aktivitet, si dhe karakteristikat e potencialeve përkatëse nga njëra



anë, dhe karakteristikat inxhinieriko - teknike të punëve të cilat zhvillohen në bazë të projektit, nga ana tjetër, shtrohet nevoja për hartimin e këtij raporti të VNM-së, ku do të përkufizohen të gjitha ndikimet relelevante që mund të paraqiten në relacionin “te impiantit” dhe “mjedisi”, duke mos anashkuar edhe ndikimet kumulative në rrethin dhe regjionin më të gjerë.

Nisur nga qëllimi paraprak dhe nga metodologjia e hartimit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, ky raport bëhet me qëllim të përkufizimit të ndikimeve potenciale dhe caktimin e masave të cilat do të jenë të nevojshme për tu marr për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative.

Me rastin e hartimit të Raportit janë marrë për bazë ndikimet në mjedis dhe aplikim i masave për zvogëlimin e ndikimeve gjatë fazës së procesit teknologjik, dhe pas përfundimit të aktivitetit.

Pra me këtë raport do të ofrohen informata të mjaftueshme për zonën ku shtrihet projekti, zonën me të gjer dhe ndikimet e këtij aktiviteti në mjedis, si dhe masat mjedisore që ndërmerren gjatë ngritjes këtyre kapaciteteve, gjatë operimit dhe pas përfundimit të aktivitetit prodhues.

Për hartimin e këtij raporti janë siguruar të dhëna nga burime të ndryshme, literatura ekzistuese, web faqja e komunës në fjalë, raportet e ndryshme mbi vlerësimin e aktiviteteve të ngjashme, dhe gjithashtu janë realizuar disa vizita në vendin ku bëhet investimi, me qëllim të njohjes me zonën, me të dhënat për pajisjet që janë dhënë nga vete investitori, procesin teknologjik dhe infrastrukturën në lokacion.



2. KUADRI LIGJORE PËR HARTIMINE RAPORTIT TE VNM-S

Me rastin e hartimit të Raportit duhet marrë për bazë ndikimet në mjedis dhe aplikimi i masave për zvogëlimin e ndikimeve, gjatë fazës së operimit të procesit teknologjik.

Ndërsa, faza e ndërtimit të objektit ku do të vendoset linja e prodhimit nuk është trajtuar në raport pasi që, objekti tani me veç është i ndërtuar si pas lejes ndërtimore të komunës së Istogut.

Analiza përfshin projeksionin e masave mbrojtëse për mjedisin me rastin e ndonjë aksidenti mjedisor gjatë procesit teknologjik edhe atë:

- identifikimin e burimit që rrezikon mjedisin
- vlerësimin e ndikimit në mjedis
- propozimin e masave themelore për minimizimin apo zvogëlimin e ndotjes deri në kufijtë e lejueshmërisë

2.1. Legjislacioni

Pikë reference për përgatitjen e VNM-së janë ligjet bazike mjedisore, ligjet për mediumet mjedisore dhe ligje të tjera që ndërlidhen me mjedisin, në veçanti Ligjit Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, që në mënyrë të qartë përcakton përgjegjësitë dhe obligimet për: investitorin, MMPHI, hartuesin e VNM-së dhe palët tjera të interesit si organe institucionale qendrore, lokale, komunitetin, organizatat joqeveritare e të tjera.

a) Dokumentacioni normativ

Ligjet më të rëndësishme të aplikuara për hartimin e VNM-së për projektin janë si me poshtë:

- Ligjit Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis;
- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025;
- Ligji për mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Nr. 03/L-160;



- Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147;
- Ligji për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174;
- Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060;
- Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147;
- Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233;
- Ligji për Mbrojtje nga Zhurma Nr. 02/L-102;
- Ligji për Ndërtim Nr. 04/L-110;
- Ligji nr. 04/L-161 (16.05.2013) për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të Punësuarve dhe Ambientit të Punës;
- Ligji nr. 08/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-197 për Kimikate;
- Ligji për mbrojtjen nga zjarri Nr. 04/L-012;
- Ligji Nr. 08/L-112 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 30/2014 për kushtet, mënyrat , parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujor;
- Udhëzimi administrativ Nr. 07/2012 për cilësinë e karburanteve të lëngëta të naftës;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 30/2014 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujor;
- Udhëzimi administrative (Ligji Nr. 04/L-230) AME-Agjensioni për Menaxhimin e Emergjencave – MPB;
- Udhëzim administrativ mmph Nr. 04 /2018 për pengimin e aksidenteve të mëdha ku përfshihen substancat e rrezikshme;
- Udhëzim administrative Nr.05/2011 për metodologjinë e vlerësimit të rrezikut nga aksidentet kimike si dhe masat për eliminimin e pasojave;
- Udhëzim administrativ (QRK) Nr.08/2017 për menaxhimin e deponive të mbeturinave;.

Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis VNM-ja mendohet si një mënyrë për të ndaluar projekte që kanë ndikime të papranueshme në mjedis por një pikëpamje



shumë më pozitive dhe e dobishme është të mendohet për VNM-në si një mënyrë për të ndihmuar zhvilluesit dhe vendimmarrësit të projektojnë projekte që të kenë ndikim sa më të vogël të mundshëm në mjedis në mënyrë që ata të mund të lejohen të shkojnë përpara dhe të sigurojnë përfitime të tjera që zhvillimi krijon për ekonominë dhe shoqërinë. VNM bën këtë duke identifikuar zbutjen e mjedisit gjatë studimeve vlerësuese.

2.3. Metodologjia e punës

Për të vlerësuar ndikimin në mjedis si dhe për të identifikuar masat para parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve në mjedis është ndjekur qasja e vlerësimit të përgjithshëm të projekteve të kësaj natyre, si dhe është bërë analiza dhe identifikimi i ndikimeve sipas fazave.

a) Informatat themelore mbi:

- ❖ Burimet themelore të ndikimeve në mjedis;
- ❖ Popullatën dhe vendbanimet në lokacion;
- ❖ Topografia dhe peizazhi në lokacionin e projektit;
- ❖ Klima dhe të dhënat meteorologjike;
- ❖ Kualiteti i ajrit ujit dhe komponentëve tjerë mjedisor në lokacion;
- ❖ Bota bimore dhe shtazore në lokacionin e projektit;

b) Vlerësimi i ndikimeve sipas kritereve në vijim:

- ❖ Gjendja e mjedisit në lokacionin e projektit;
- ❖ Lloji dhe madhësia e pritshme e ndotjes nga projekti;
- ❖ Karakteristikat dhe përbërja e materialit ndotës;
- ❖ Vlerësimi i përhapjes së ndotjes;

c) Përcaktimi i masave për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve në mjedis, duke u bazuar në rezultatet/të gjeturat nga vlerësimi i ndikimeve në mjedis, në lokacionin e projektit.



2.3. Qëllimi i hartimit të VNM-së

Qëllimi kryesor i hartimit të VNM-së është evidentimi dhe identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në mjedis dhe marrja e masave të domosdoshme për minimizimin dhe parandalimin e efekteve të dëmshme në mjedis gjatë studimit, projektimit dhe me pas ndërtimit të këtij objekti e shfrytëzimit të tij.

Qëllimi kryesor i hartimit të VNM-së është të identifikojë mënyrat se si projekti i propozuar mund të hartohet dhe të transformohet në mënyrë të tillë për të zbutur efektet e padëshiruara në mjedis. Në mënyrë të thjeshtë, zbutja e mjedisit është konsideruar të përfshijë ndonjë veti të projektit të propozuar, i cili shmangë, zvogëlon ose riparon efektin e saj negativ mbi mjedisin apo siguron përfitime mjedisore. Masat zbutëse mund të përfshijnë aspektet fizike të projektit apo mënyrat sipas të cilave ai është projektuar dhe do të ndërtohet.

Përmes Raportit të VNM-së do të analizohen karakteristikat e gjendjes ekzistuese të mjedisit në lokalitetet ku do të vendoset fabrika e ujit, si dhe karakteristikat e potencialeve përkatëse, nga njëra anë, dhe karakteristikat tjera mjedisore të punëve të cilat zhvillohen në bazë të projektit, nga ana tjetër.

Raporti i VNM-së ofron një vlerësim të ndikimeve të mundshme pozitive dhe negative që Projekti i propozuar mund të ketë për mjedisin dhe komunitetet, së bashku të përbërë nga mjedisi, biodiversiteti, trashëgimia kulturore dhe aspektet socio-ekonomike.

Qëllimi i VNM-së është të sigurojë që palët e interesuara janë plotësisht të informuar dhe vendimmarrësit i konsiderojnë ndikimet mjedisore dhe shoqërore si negative dhe pozitive, kur vendosin nëse do të vazhdojnë me projektin.

Duke u nisur nga qëllimi paraprak dhe në metodologjinë e hartimit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, ky Raport i VNM-së bëhet me qëllim të përkufizimit të ndikimeve potenciale dhe caktimin e masave të cilat do të jenë të nevojshme për t'u



ndërmarrë për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative. Me rastin e hartimit të Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis do të merret për bazë identifikimi i ndikimeve negative në mjedis dhe aplikimi i masave për zvogëlimin e ndikimeve gjatë fazës së funksionimit.

Objektivi i këtij raporti është vlerësimi në mënyrën e duhur të efekteve të drejtpërdrejta dhe indirekte të këtij projekti sipas klasifikimit:

- Efektet në njerëz pranë dhe afër kësaj rruge;
- Ndikimet në tokë, ujë, klimë dhe peizazh të zonës;
- Ndikimet në materiale dhe asete kulturore;
- Ndërveprimet midis këtyre faktorëve që përmendem;

Pra, Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis ka si objektiv të përcaktojë:

- Përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të drejtpërdrejta apo të tërthorta të mjedisit gjatë kohës së rikonstruksionit të kësaj rruge;
- Ndikimet mjedisore në lidhje me gjendjen e mjedisit ku do të realizohet ky projekt;
- Propozimin e masave të nevojshme për parandalimin, reduktimin, zbutjen dhe minimizimin e ndikimeve negative dhe rritjen e ndikimeve pozitive në mjedis;

Gjatë procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis kryhen identifikimi, përshkrimi dhe vlerësimi, në mënyrën e duhur, i ndikimit në mjedis të një veprimtarie, duke përcaktuar efektet e mundshme, të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta mbi tokën, ujin, ajrin, pyjet, klimën, shëndetin e njeriut, florën dhe faunën, peizazhin natyror, pasuritë materiale e trashëgiminë kulturore, duke pasur parasysh lidhjet e tyre të ndërsjella.



3. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT DHE MJEDISIT

Në këtë kapitull do të bëjmë përshkrimin e lokacionit ku është ndërtuar objekti i fabrikës me objektet shoqëruese, përshkrimi do të bëhet në aspektin e vendbanimit, ujërave, erë, florë dhe faunë etj.

3.1. Pozita gjeografike e impiantit

Komuna e Istogut shtrihet në pjesën veriore të rrafshit të Dukagjinit. Komuna, në veri-perëndim kufizohet me Malin e Zi dhe Serbinë, në veri-lindje me komunën e Zubin Potokut, në lindje me komunën e Skenderajt, në jug me komunën e Klinës dhe në jug-perëndim me komunën e Pejës. Qendër komunale është qyteti Istog. Komuna ka 50 vendbanime prej të cilave 1 është qytet-Istogu, 1 vendbanim është qytezë-Gjurakoci dhe tjera vendbanime janë fshatra: Baja, Bajica, Llukavci i Begut, Belica, Bollopoja, Veriqi, Vrella, Orroberda, Dobrusha, Istogu i Poshtëm, Dragolevci, Dreja, Dubrava, Zhakova, Zallçi, Zabllaqi, Kaliqani, Kashica, Kovraga, Koshi, Kërnina, Llugat, Lubova, Lubozhda, Dubova e Vogël, Mojstiri, Muzhevina, Veriqi i Ri, Osojani, Polana, Prekalla, Prigoda, Rakoshi, Syneja, Serbobrani Saradrani, Cërkolezi, Sudenica, Llukavci i Thatë, Suhogërllë, Shushica, Tomoci, Trubuhoci, Tuqepi, Uça, Corolluka, Cërrca dhe Shalinovica.



Figura 1. Komuna e Istogut shtrihet në pjesën veriore të rrafshit të Dukagjinit.

Ndërsa Lokacioni ku është ndërtuar objekti i fabrikës së kompanisë Anahita Sh.p.k. është brenda kufirit të Komunës së Istogut dhe është pajisur me leje ndërtimore nga komuna.

Lokacioni ku është ndërtuar Fabrika e Ambalazhimit të ujit është në pjesën Veri Perëndimore të Republikës së Kosovës më saktë në territorin administrativ të

komunës së Istogut përkatësisht në parcelën me Nr.00875-0, ZK. Cerrcë në largësi nga Qendra e Istogut 2.0 km.




Figura 2. Foto lokacioni i fabrikës.

Me poshtë janë paraqitur disa foto nga lokacioni i objektit i cili është në përfundim e sipër, ku shihet që ndërtimi ka përfunduar.



Figura 3. Foto te objektit te ndërtuar.

3.2. Popullata dhe vendbanimet

Gjatë hartimit të raportit VNM-së, ndër veçoritë kryesore që duhet me i kushtuar kujdes për t'i trajtuar janë edhe vendbanimet. Kjo vjen në shprehje për shkak se afërsia e vendbanimeve dhe popullatës ndaj aktiviteteve, pasi që janë ndër faktorët kryesor të cilët i ekspozohen ndikimeve në mjedis.




Figura 4. Lokacioni i fabrikës dhe distanca me shtëpitë.

Njërin nga veçoritë qenësore të hapësirës së analizuar, në kuptim të përcaktimit të ndikimeve të mundshme në mjedis, paraqet popullatës dhe demografia e saj. Këto fakte kuptimin e plotë të tyre e kanë në hulumtimin e hollësishëm të ndikimeve të mundshme negative në banorë që jetojnë dhe hapësirën e analizuar. Si pas vizitave ne teren dhe ortofotove të bashkangjitur këtij raporti (fig 2 dhe 4) objektet banuese janë ngjitur me parcelën ku është objekti i fabrikës.

Mirepo duke e pasur parasysh aktivitetin që do të zhvillohet në fabrike mendojmë që nuk paraqet ndonjë problem për popullatën në këtë lokacion dhe si i tillë



impianti në fjalë nuk do të ketë ndonjë ndikim negativ relevant në popullatë, përpos që do të kenë vetëm dobi në aspektet ambientit dhe ekonomik.

3.3. Lidhjet e Komunikacionit

Lokacioni ku do të vendoset impianti në fjalë ka lidhje mjaftë të mirë me rrjetin e rrugëve, pasi që ka një qasje të lehtë në rrugën që lidhe me qytetin e Istogut ku me pas do të lidhet me qendra tjera. Nga kjo mund të përfundojmë se lokacioni ka lidhje të mira komunikacioni, me të cilën rritet vlera nga aspekti ekonomik. Ne (fig 2) janë paraqitur rrugët.

3.4. Kushtet klimatike

Territori ku do të ndërtohet impianti në Komunën Istog, kryesisht ka klimë kontinentale dhe mediterane të modifikuar që karakterizohet me vera të nxehta dhe dimra të ftohtë e të pasur me reshje sidomos gjatë vjeshtës, dimrit dhe pranverës së hershme.

Reshjet janë të pranishme sidomos gjatë vjeshtës, dimrit dhe pranverës, dhe ato janë të formës së ndryshme (shi, borë, breshër) me karakter të gjerë gjatë dimrit ose me karakter lokal gjatë pranverës dhe verës. Gjatë periudhës vegetative sasia e të reshurave në Dubrushë është rreth 60 mm. Reshje me se shumti ka në nëntor (113 mm) dhe dhjetor (107 mm) ndërsa me së paku ka në gusht vetëm 44.3 mm.

Temperatura mesatare sillet prej 11.2°C gjer në 11,9°C. Temperaturat më të larta janë regjistruar në muajin korrik dhe gusht ku shpesh mund të arrijnë deri në 39°C. Temperaturat minimale vjetore mund të arrijnë deri -29°C. Mesatarja vjetore për Pejë është 11.1 °C. Në përgjithësi muaj të nxehtë dhe të thatë janë muajt korrik, gusht dhe shtator.



Tabela 1. Të dhënat Statistikore - Mujore për Klimën

Muajt / Parametrat	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
Reshjet mesatare në (mm)	77	61	54	47	59	56	36	40	41	55	91	86
Temperatura mesatare (°C)	-0.4	0.8	8.5	11.8	16.1	18.4	20.3	19.6	18.4	11.5	5.7	1.3
Diellzimi mesatar (h)	70	102	147	184	221	258	299	289	222	168	95	66

Në komunën e Istogut erërat më të shpeshta janë ato që vijnë nga veriu dhe ato nga jugu që shpesh mund të zhvillojnë shpejtësi të caktuar.

Tabela 2. Temperaturat Mesatare, Sipas Stinëve të Vitit

Muajt / Parametrat	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
Reshjet mesatare në (mm)	77	61	54	47	59	56	36	40	41	55	91	86
Temperatura mesatare (°C)	-0.4	0.8	8.5	11.8	16.1	18.4	20.3	19.6	18.4	11.5	5.7	1.3
Diellzimi mesatar (h)	70	10	147	184	221	258	299	289	222	168	95	66

3.5. Natyra dhe biodiversiteti

Monumentet Natyrore –Përgjatë territorit të komunës së Istogut gjenden lokacione që përmbajnë një ose më shumë monumente natyrore me veçori specifike dhe vlera unike– rariteti, veçori natyrore, vlera rekreative ose estetike dhe vlera të posaçme kulturore. Mbrojtja e natyrës duhet të jetë e inicuar dhe të zhvillohet në bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit në Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Llojet e ndryshme të monumenteve natyrore duhet të trajtohen me metoda të ndryshme të mbrojtjes. Janë tri lloje të monumenteve natyrore në komunën e Istogut të mbrojtura sipas Ligjit për Konservimin e Natyrës, neni 20, të cilat bazohen në veçoritë e tyre:



- ✓ Hidrologjike
- ✓ Botanike Monumentet natyrore me veçori hidrologjike janë të rëndësishë së veçantë për zhvillim në komunën e Istogut.

Në listën e monumenteve natyrore të mbrojtura me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, në komunën e Istogut janë tri burime:

- ✓ Burimi i ujit natyral në Istog
- ✓ Burimi i ujit natyral në Vrellë
- ✓ Burimi i ujit termomineral në Banjë

Zonat e mbrojtura këtu, pos vendit të burimit ujqor përfshijnë edhe vendndodhjen dhe sipërfaqen rreth burimit (pika 2, neni 3, nr. 40 – 13/07 Udhëzimi Administrativ- Kriteret për përcaktimin e Zonave të Mbrojtura Ujqore dhe masat e tyre mbrojtëse për burimet e ujit që përdoren për pije).

Burimet e ujërave termomineral në Banjë hyjnë në zonën e parë të mbrojtjes (neni 4, nr. 40 – 13/07 Udhëzimi Administrativ- Kriteret për përcaktimin e Zonave të Mbrojtura Ujqore dhe masat e tyre mbrojtëse për burimet e ujit që përdoren për pije).

Kjo zonë e mbrojtjes i takon regjimit të rreptë, që përfshin mbrojtjen e drejtpërdrejtë rreth burimit të ujit dhe objekteve me instalime për marrjen e ujit si dhe mbrojtjen e burimit nga shkarkimet e ndotësve që mund të vijnë nga aktivitetet e njeriut. Shfrytëzimi, veprimi dhe mbrojtja në këto zona duhet të jenë në pajtim me nenet 21, 22, 23, 24 dhe 25 të këtij udhëzuesi.

3.6. Flora dhe Fauna

Problematika e gjendjes ekzistuese të llojeve bimore nuk është studiuar në masë të mjaftueshme për të sjell përfundime meritore.

Mirëpo, në bazë të shqyrtimeve vizuale në rrethinë të zonës ku është duke u realizua projekti kemi hasur në bimësi që karakterizohet kryesisht nga bimët e ultë barishtore, kulturat periodike bujqësore si dhe bimësi drusore si plepi, kurse në lokalitetin më të gjerë dominojnë bagreni dhe bungu, si dhe kaça, murrizi, mana, manaferra etj.



Duke marrë parasysh karakteristikat e gjendjes ekzistuese mund të konstatohet se në lokacionin e këtij regjioni nuk ka potenciale të shprehura të vegjetacionit të cilat mund të rrezikohen me ndërtimin dhe funksionimin e impiantit.

Problematika e gjendjes ekzistuese të llojeve shtazore nuk është studiuar në masë të mjaftueshme për të sjell përfundime meritore në këtë domen. Bazuar në florën ekzistuese dhe kushtet klimatike të rajonit, e duke marrë për bazë edhe të dhënat nga vendasit, në këtë zonë jetojnë: gjitarët, insektet e ndryshme, lepuri i egër, dhelpra, iriqi etj. Ndërsa prej shpezëve janë karakteristike: bilbilat, thëllëza e fushës, sorrat, shqiponja.

Lokacioni ku po ndërtohet impianti është në një zonë në mes të objekteve të ndryshme, industriale dhe shtëpive për banim kjo nënkupton që zona ka qenë e afektuar edhe me herët.

Zona është tërësisht e degraduar nga faktori njeri, pasi që është shndërruar në një zonë me objekte të banuara dhe atyre industriale në këto parcela ku është planifikuar të ndërtohet impianti.

3.7. Peizazhi

Peizazhi, paraqet një nga veçoritë e rëndësishme të cilat duhet trajtuar në kuadër të vlerësimit të ndikimeve në mjedis. Edhe pse si definicion, paraqet një tërësi të elementeve natyrore, me vlerë vizuale dhe relaksuese, që d.m.th. në kuptimin e ndotjes dhe emisioneve nuk paraqet efekte direkt në shëndet, megjithatë kjo duhet trajtuar dhe vlerësuar me kujdes.

Siç është përshkruar më lartë, lokacioni ku është ndërtuar objekti dhe planifikohet të vendoset linja e prodhimit të ujit, është një lokacion në lindje të qytetit të Istogut dhe nuk parashihet që do të sjellte ndonjë problem. Sipas vizitave në teren në këtë lokacion tani më veç që ka pësuar një ndryshim të vrazhdë peizazhi nga faktori njeri, ku kjo zonë janë realizuar disa objekte industriale.



Nga argumentet me larte nga ndërtimi i impiantit nuk do te përkeqësohet peizazhi ne kuptimin natyror, vetëm qe do te merre një pamje me te mire.

Si përfundim e këtyre argumenteve që u prezantuar, mund të themi që ky projekt nuk paraqet ndonjë kundërshtim, konflikt apo papranueshmëri në kuptimin peizazhi.

3.8. Ajri

Në territorin e komunës së Istogut deri tani nuk janë bërë matje mbi shkallën e ndotjes së ajrit, ujit, tokës dhe zhurmës në mënyrë që të bëhet një vlerësim sa më preciz i gjendjes mjedisore për lokacionin ku është ndërtuar objekti i fabrikës.

Nga vet konfiguracioni i terrenit dhe prezenca e florës, dhe mos ekzistimit të objekteve industriale në këtë lokacion, si dhe mos funksionimit të ish objekteve industrial në Istog, mund të konkludojmë se pastërtia e ajrit në këtë regjion është në nivel të lakmueshëm.

Ndërsa bazuar në llojin e veprimtarisë së impiantit, mund të konstatohet se nuk ka shqetësime, presione apo tregues që mund të diktojnë degradimin e kualitetit të ajrit në territorin e komunës në përgjithësi si dhe në lokacionin e projektit në veçanti.

3.9. Karakteristikat hidrologjike

Komuna e Istogut ka rrjet mjaft të zhvilluar hidrografik, gjegjësisht ka numër mjaft të madh të lumenjve (përroskave) që kalojnë në territorin e saj.

Lumenjtë e vegjël janë lumenj me tipare karakteristike për përroskat malore, që do të thotë se janë lumenj të vegjël, me oscilime shumë të mëdha të sasisë së ujit gjatë vitit. Gjatë thatësirave, në shumicën e këtyre lumenjve ka shumë pak ujë ose nuk ka ujë fare, kurse gjatë kohës me reshje shpesh ndodh që të ketë vërshime lokale.



3.9.1. Lumenjtë dhe Burimet

Lumenjtë kryesor në komunën e Istogut janë: lumi i Istogut, lumi i Vrellës dhe Drini i Bardhë, ndërsa rrjedha tjera ujore me rëndësi janë edhe: Shushica, Përroi i keq, Çausi, Gujavçi, Bllagaça dhe lumi i Renovcit.

Lumi i Istogut është arteria kryesore hidrografike. Ky lum e ka burimin e vet nga ujërat nëntokësore të Moknës. Istogu është një ndër degët e majta të lumit më të madh në Kosovë, Drinit të Bardhë. Sipërfaqja e pellgut të Istogut është $F=434.7$ km², kurse gjatësia e lumit është $L=14.0$ km'. Lumi Istog kalon nëpër qytetin e Istogut. Mbi gjysma e sipërfaqes së pellgut janë toka punuese dhe livadhe e kullosa, mirëpo ka edhe shumë sipërfaqe me djerrina, 10% male etj.

Nga burimi i lumit të Istogut, që ndodhet në afërsi të qytetit të Istogut, rrjedhin 3.0 m³/sec ose (75-126) *106m³. Uji i këtij burimi shfrytëzohet për qëllimet në vijim:

- Për pije
- Për ujitje
- Për ekonomi peshku
- Për prodhimin e energjisë elektrike

Uji nga burimi merret nga dy krahët e tij. Në krahun e majtë merren $Q=0,8$ m³/s për ujitje, kurse në anën e djathtë merren 2.86 m³/s. Kjo sasi e ujit përdoret për tri qëllime: sasia prej 0.86 m³/s shfrytëzohet për ujë të pijes gjatë gjithë vitit, sasia prej 2.0 m³/s shfrytëzohet për ujitje gjatë muajve qershor-shtator, kurse gjatë muajve tjerë të vitit shfrytëzohet për prodhimin e energjisë elektrike. Pas daljes së ujit nga HEC-i, përmes kanalit të posaçëm dërgohet në rezervatin e rritjes së peshkut.

Lumi i Istogut është i pasur me ujë dhe siguron sasi të konsiderueshme të ujit për ujitjen e sipërfaqeve të punuara, pastaj për hurdhën e peshqve, hidrocentralin në Istog, si dhe për ujësjellësin e Istogut dhe të Gjurakocit.

Lumi i Vrellës shfrytëzohet për furnizimin me ujë të vendbanimit të Vrellës, pastaj edhe për ujitjen e tokave të saj si dhe të fshatrave të afërta. Deri në ndërtimin e ujësjellësit Radavc-Banjë, uji i burimit të Vrellës është shfrytëzuar për furnizimin me ujë të pijshëm të banorëve të Banjës.



Burimi i Vrellës ka prej 0.17-2.0 m³/sek, i cili është kaptuar dhe që kryesisht eksploatohet për ujitje, ndërsa një pjesë e vogël përdoret për furnizimin me ujë të fshatrave përreth.

Drini i Bardhë më gjithë kapacitetin e tij shërben për ujësjellësin Radavc-Banjë, shfrytëzohet për ujitjen e tokave në territorin e komunës së Istogut, krahas me një pjesë të territorit të komunës së Pejës. Drini i Bardhë është kufiri natyral në mes të komunave Istog dhe Pejë.

3.9.2. Ujërat nëntokësore

Ujërat nëntokësore të lumenjve janë ujëra burimorë potencial për shfrytëzim, sidomos për nevoja të ujitjes së sipërfaqeve bujqësore. Sipas shtrirjes së lumenjve të këtij territori, me pasuritë e tyre me ujë prej 3-10m dhe koeficient të porozitetit prej 20%, fitohen rezerva të ujit në aluvijolin e lumit të Istogut me afro 37x10⁶ m³/vit.

Ujërat nëntokësore nuk shfrytëzohen për furnizim të ujësjellësit, por shfrytëzohen për pije nga pusët (bunarët) familjare. Këto ujëra janë të ndotura në mënyrë indirekte nga përdorimi i plehrave minerale dhe pesticideve, por në një masë të vogël. Ujërat nëntokësore më së tepërmi ndoten nga derdhjet e ujërave të zeza.

3.9.3. Ujërat termo-minerale

Banja, e cila gjendet 15 km në pjesën perëndimore të Istogut, në vendin ku gjenden shpatijet e fundit të Moknës dhe Zhlebit, të cilat shkrihen në Rrafshin e Dukagjinit, është e njohur me burimet e ujërave të nxehta. Temperatura e ujit e burimeve të nxehta është 46-48 °C, kurse sasia e përgjithshme e ujërave të tyre është 17,5 l/sec. Për nga cilësitë e tyre, hyjnë në radhën e ujërave tokësore-alkale, karbo-të tharta dhe me përmbajtje të vogël të sulfurit. Mjekojnë reumatizmin, ishiasin, sëmundjet e lëkurës, sëmundjet e eshtrave dhe nervave, si dhe sëmundjet kronike të femrave. Përveç ujit mineral të nxehtë, ekzistojnë edhe dy burime të vogla të ujit mineral të ftohtë. Këto nuk janë të rregulluara, por duhet t'u kushtohet rëndësi në të ardhmen,

megënëse ekzistojnë indikacione për mundësinë e përdorimit të këtij uji për qëllime mjekuese.

Veçoritë hidrologjike, të lokacionit ku është ndërtuar objekti dhe pritet të vendoset linja e mbushjes së ujit ndodhet Lumi Burimi me një distancë mbi 660m.



Figura 5.Distanca në mes të lokacionit dhe lumit.

Duke u bazuar në hartat topografike dhe vizitat në terren, në aspektin hidrogeologjik në hapësirat ku është ndërtuar objekti i impiantit, në afërsi nuk ka ndonjë lume ose rrjedhe ujore që do të ishte në kundërshtim me ligjin për VNM. Megjithatë në një distancë në 660 m, gjendet lumi Burimi.

3.10. Karakteristikat Gjeologjike dhe Hidrogeologjike të Zonës

3.10.1. Karakteristikat Gjeologjike të Rajonit

Zona ku është lokacioni i fabrikës, ndahet në dy pjesë të ndryshme në aspektin gjeologjik: terreni në kufijtë e rrafshit aluvial me ngritje dhe rënje si dhe vetë rrafshi aluvial i lumit i cili ndodhet ndërmjet dy lumenjve të Istogut .

Në bazë të dhënave nga hulumtimet të të dhënave të hulumtimeve të deri tanishme, hartat gjeologjike ekzistuese (Harta gjeologjike 1: 100 000 dhe 1:25 000)



dhe vrojtmeve fushore, është bërë deshifrimi i ndërtimit dhe karakteristikave gjeologjike, tektonike e stratigrafike të zonës së gjerë.

Në basenin i cili është i krijuar nga lëvizjet tektonike me çarje dhe fundosje të ngadalshme, kushtet e sedimentimit janë ndryshuar me kohë.

Zona e gjerë e studimit ndërtohet nga formacionet më të ndryshme, mandej nga sedimentet:

- ✓ Sedimenteve liqenore-lumore (jQ),
- ✓ Depozitimeve proluviale (pr) dhe
- ✓ Aluviale (al).

3.10.2. Sedimentët Liqenore - Lumore (JQ),

Në këtë zonë kanë përhapje të madhe, veçanërisht në territorin e zonës Istogut, ku mbulojnë sedimentët e Miocenit dhe Pliocenit. Sedimentët liqenore - lumore përfaqësohen nga suargjilat zhavorike, ngjyrë të kuqe-braon, ose nga zhavorret argjilor, mbi të cilët shtrihen suargjilat e verdha, rërat kokëtrasha dhe zhavorret. Trashësia e këtyre depozitimeve lëkundët nga 5 m deri 29 m.


Karakteristikat hidrogeologjike të depozitimeve liqenore-lumore në përgjithësi janë jo të volitshme. Përfundim nga ky cilësim hidrogeologjik i këtyre sedimenteve, bëjnë vetëm ato vende ku ka ndodhë depozitim më i fuqishëm i rërave dhe zhavorreve në sedimentët liqenorelumore e të cilat vende mund të paraqesin ambiente ujëmbajtëse të ujërave nëntokësor.

3.10.3. Depozitimet Proluviale (Pr)

Këto depozitime paraqiten në mes Istogut e Sinajës. Janë forma konike të përbëra nga zhavorret heterogjen dhe rërat, shpeshherë me sasi të caktuar edhe të argjilës. Në disa raste, kurkanë trashësi relativisht të madhe, paraqesin ambiente të volitshme për formimin e akuifereve të ujërave nëntokësor freatik.

3.10.4. Depozitimet Aluviale (Al)

Ndërtojnë hapësira të mëdha përgjatë rrjedhave ujore (Sushica etj) dhe përfaqësohen nga zhavorret, rërat dhe ndërshtresa të rralla të suargjillave. Aluvionët me trashësi dhe shtrirje të madhe, paraqesin ambiente të volitshme për grumbullimin e ujërave nëntokësor.



Legend		PALAEOGENE	
QUATERNARY		Oligocene	
Holocene		Upper Oligocene	
	aQh Alluvium - gravel, sand, silt		kEo ² Conglomerate
	pQh Proluvium - fanglomerate of rock fragments, sandy-silty deposits		lEo ² Limestone, partly marly and dolomitic
	dQh Deluvium - rock fragments, sand, silt		sEo ² Sandstone, marlstone, mudstone, partly tuffitic, magnesite and lignite bearing
Pleistocene		Lower Oligocene	
	cQp Calc tufa / travertine		lEo ¹ Reef (corals) limestone
	rQp River terraces - gravel, sand		kEo ¹ Conglomerate, sandstone, marlstone, claystone, partly limestone, pyroclastic rocks
	lQp Lake sediments - gravel, sand, silt, clay	CRETACEOUS	
	bQp Boulder field	PASHTRIK CRETACEOUS (P)	
	gQp Glacigenic sediments - moraine, fluvio- and limnoglacial deposits	Coniacian - Maastrichtian	
NEOGENE			Kcn-mP Limestone, marlstone, calcarenite with chert
Pliocene		Turonian	
Upper Pliocene			KtP Sandy limestone with Rudists
	Np ² Clastic sediments, clay, sand, gravel, partly marl, tuffite	Cenomanian	
Lower Pliocene			KcP Conglomeratic banked limestone
	Np ¹ Clastic sediments, clay, sand, gravel, marl, carbonate lenses, burnt rock, lignite	Aptian - Cenomanian	
Miocene			Ka-cP Thin-bedded limestone, calcarenite
	Nm Conglomerate, sandstone, marlstone, claystone	Aptian	
Upper Miocene			KaP Conglomerate, chert, sandstone

Figura 6. Harta gjeologjike e terrenit.



3.11. Karakteristikat Hidrogeologjike

3.11.1. Akuiferet dhe llojet e tyre

Duke u bazuar në të dhënat e pasqyruar në hartën gjeologjik dhe hidrogeologjike, si se punimet hulumtuese të deritanishme për rajonin e gjerë dhe vet zonën në studim janë veçuar këto lloje të akuiferëve si në vijim: Akuiferi në depozitimet aluviale dhe Akuiferi në depozitimet proluviale.

3.11.2. Akuiferi në depozitimet aluviale

Depozitimet aluviale janë të përhapura përgjatë luginave lumore duke formuar tipin e akuiferit në depozitimeve aluviale, pra ky formacion përhapje të gjerë dhe mbulon 50.00% të zonës së gjerë dhe ka porozitet intergranular. Depozitimet aluviale në aspektin litologjik përbëhen nga sedimente të palidhura; rërë, rërë dhe zhavorr, të cilat kanë karakteristika të mira të filtrimit dhe lidhje të mira hidraulike për ujërat nëntokësor.

3.11.3. Akuiferi në depozitimet proluviale

Depozitimet e proluviale shtrihen në zonën lumore në zonën e hulumtimit. Ky akuifer ka shtrirje jo të gjerë për shkak të se zona e lumit është me gjerësi jo të madhe, andaj edhe depozitimeve nga veri-lindja në drejtim të jug-perëndimit në këto depozitime proluviale është realizuar shpimi. Figura 9 Harta Hidrogeologjike.

3.11.4. Hulumtimi i ujërave nëntokësor

Hulumtimet e ujërave nëntokësorë në këtë rajon dhe analizimi i cilësisë së tyre në aspektin fizik, kimik dhe bakterologjik për ta shfrytëzuar këtë ujë për nevoja sanitare apo industriale janë bërë në vitin 2009, me qëllim të studimit më të hollësishëm të nivelit të ujërave nëntokësor, sasisë së ujëdhënjes, përcaktimin e cilësisë, përcaktimin e drejtimin të rrjedhjes të ujërave nëntokësor dhe përkufizimin e trupit ujqor nëntokësor.

Në territorin e Istogut dhe më gjerë janë hapur puse nga banorët lokal për shfrytëzimit e këtij ujit për qëllime teknike dhe bujqësore të cila kanë dhënë rezultate të kënaqshme të ujëdhënjes.

Ujërat nëntokësor shtrihen në shkëmbinjtë kolektor përgjatë terecave lumore dhe shtrihen në luginën e Lumit Istogut dhe Drinit të Bardhë, lumit të vrellës dhe konsiderohen se janë kolektor të mirë të ujërave nëntokësor, ndërsa formacionet më pak të përshkueshëm konsiderohen formacionet e pliocenit të cilat janë formacione argjilore jo ujëlëshuesi. Figura 10

Drejtimi i rrjedhjes së ujërave nëntokësor është përcaktuar në vitin 2009, me testimin dhe analizimin e puseve të hapura e cila ka drejtim e rrjedhjes nga veri perëndimin në drejtim të jugë lindjes në drejtim të rrjedhjes së ujërave sipërfaqësor figura 9.

Prurjet e ujit në kuadër të kësaj zone ndryshon prej 2 – 10 l/sec.




Figura 7 Pasqyra e lirë të ujërave nëntokësor në zonë Istogut

Regjimi i vrushkujve ne zonën e ultësirës së Lumit Istog dhe Cerrcë deri te bashkimi me Drinin e Bardhë me nivel maksimal arrijnë në periudhën mars-maj,



dhe niveli minimal ne periudhën gusht-tetor. Në këtë zonë nuk kem të dhëna të sakta regjionale për amplitudën mesatare shumëvjeçare të oscilimit të nivelit të ujit nëntokësor. Në bazë të matjeve të tanishme në pusët në zonat e afërta nivel më të ultë varësisht nga stinët e vitit dhe reshjeve atmosferike.

3.11.5. Karakteristikat hidraulike të zonës

Lidhja e mirë hidraulike e ujërave nëntokësorë me ato sipërfaqësorë ndikon jo vetëm në ruajtjen e bilancit ujor të komplekseve aluvialë por edhe për freskinë e ujërave, falë ushqimit të vazhdueshëm të akuiferëve. Akuiferët që lidhen me depozitimet e këtij kompleksi janë përgjithësisht të tipit poroz dhe përmbajnë kryesisht ujëra të tipit freatik. Këto ujëra karakterizohen nga këto veti kryesore:

- Janë ujëra pa presion (nivel të lirë)
- Luhatja e nivelit të ujit varet kryesisht nga reshjet atmosferike
- Regjimi i tyre varet nga pozita gjeografike, klima, relievi, rrjeti hidrografik, mbulesa e tokës etj.
- Shtirja e horizontit ujëmbajtës përputhet me zonën e ushqimit
- Kanë përgjithësisht lidhje hidraulike me ujërat e lumenjve
- Ushqehen nga lumi dhe ushqejnë lumin me ujë, respektivisht gjatë stinëve të thata dhe me reshje. Ushqimi i ujërave nëntokësorë në këtë tip akuiferi vjen si nga reshjet atmosferike (shiu, bora etj.) edhe nga drenimi i ujërave nga basenet anësore karstikë dhe mallasikë.

3.11.6. Karakteristikat sizmike

Sizmikja mikro-regjionale e këtij lokacioni dallohet me mundësi të dridhjeve të tokës të intensitetit prej 6- 7 shkallë të Merkalit. Sipas hartave sizmike të regjionit, hapësira e gjerë e hulumtuar nuk i përket një intensiteti të njëjtë të dridhjeve sepse varet nga karakteristikat gjeologjike të tokës, ujërave nëntokësore, etj.

4. PËRSHKRIMI I INFRASTRUKTURA DHE PROCESIT TEKNOLOGJIK

Bazuar ne ligjin për Vlerësimin e Ndikimit ne Mjedis, Ligjit Nr. 08/L-181 Përmbajtja e Raportit të VNM- përshkrimin e karakteristikave kryesore të procesit të prodhimit, është e detyrueshme që të bëhet përshkrimi i procesit teknologjik gjatë hartimit të raportit të VNM-së. Prandaj në këtë kapitull do të bëjmë përshkrimin e procesit teknologjik dhe objekteve shoqëruese.

4.1. Procesi teknologjik i prodhimit

Duke filluar nga para forma, shishet PET fryhen. Procesi i rritjes së shisheve ose fryrjes së tyre.



Figura 8. Forma e shishëve.

Tendenca është prodhimi i shisheve duke filluar nga paraforma. Shishe PET 12,1 0,5-1,5 L Teknologji lineare fryrjeje Kapaciteti i preferuar i sistemit linear (linear) në teknologjinë e fryrjes është **12.000 shishe/orë**.

Është një sistem që fillon nga sistemi i paraformës, i cili do të transferohet në grupin e ngrohjes në vendosjen e paraformës dhe vazhdon duke i rrotulluar preformat përmes tuneleve të ngrohjes në madhësinë e specifikuar të procesit, përkatësisht. Qëllimi i këtij sistemi është të sigurojë temperaturat në pikat e përcaktuara në procesin e shisheve me sukses të përsosur.

Para format e nxehta transferohen në kallëp.

Ka 8 dhoma në 1 kallëp dhe këto dhoma janë kallëpet që kalojnë në funksionim për modelin e specifikuar të shisheve. Shishet e transferuara në kallëp marrin formën e

shishes në kallëp të përpunuar me presion ajri afër 40 bar dhe bëhet transferimi për mbushje.

Linja 0,5 lt – 1,5 l




Figura 9. Ilustrim - modeli i makinerisë e cila do të prodhojë format e shisheve

BLW 8C2-SRV Formim me fryrje me shtrirje për shishet.

- Makinë fryrje lineare plotësisht elektrike e pajisur me 8 zgavra.
- E dedikuar për të gjitha shishet i përket gamës 0,2 lt -2 lt
- Mund të prodhojë shishe të lehta
- Është i pajisur me mbulesa sigurie sipas standardeve evropiane
- Gjatë fazës së ngrohjes, sigurohet një shpërndarje e përkryer simetrike e nxehtësisë
- Fazat e shtrirjes dhe fryrjes të drejtuara nga servo motorët
- Sistemi i PC-ve industriale kontrollohet në mënyrë elektronike.
- Kompjuteri industrial ka portën Ethernet, kështu që procesi ka mundësinë të aksesojë menjëherë problemet përmes internetit
- Të gjithë parametrat e procesit mund të vendosen nëpërmjet PC-së industriale, madje edhe ngrohjen
- Grupi i transferimit të kapësës elektronike të kontrolluar nga servo dhe paraformave sigurojnë procesin e transferimit pa humbje
- Sistemi i mbrojtjes nga nxehtësia e qafës
- sistem ftohjeje për mykun
- ndryshim i shpejtë i formatit




Figura 10. Fotografia është vetëm për qëllime ilustrimi dhe nuk përputhet me kusht me makinën e dhënë.

Ushqyes para formues

- Hopper
- Ashensor

Konzola e Kontrollit - Ndërfaqe grafike e ekranit me prekje TFT me 10 ngjyra për të aksesuar të gjithë parametrat për kontrollin e makinës, konfigurimi i procesit, konfigurimi mekanik, konfigurimi i procesit të mirëmbajtjes pajisjet e shërbimeve;

1- Kompresor

2- Çiller

Tabela 3. Kapacitetet e pjesëve ndihmëse në varësi të specifikave të vendit (lartësia, temperatura, lagështia etj.)

Characteristics	Type
Fuqia e instaluar	160 kw
Konsumi	60 kw
Ajri me presion të ulët	2m ³ /minute- 8 Bar
Ajri me presion të lartë	11 m ³ / minute -38 Bar
Uji Ftohës	60.000 kcal/hour 5-7°C
Pompë uji ftohës	30 ton/hour ΔP=3 Bar. (ΔP=Pin-Pout)
Tensioni	380 V 3 phase 50 Hz Variable Frequency
Kontrolli i makinës	PLC
Characteristics	Type



Pajisje ndihmesë - Ftohës i sistemeve të ajrit me presion të lartë dhe të ulët, Pozicioni përfundimtar për ftohësin dhe kompresorin HP do të përcaktohet sipas matjeve të vendit (maksimumi 10 m- 15 m nga derdhja me fryrje)

Tabela 4. Cilësia e ujit të ftohjes dhe qarqeve të shpërndarjes

Parameters	Value
TH (Fortësia totale)*	6.5 < pH < 8
TA (Simple Alkalinity)	TH < 5 °F - 50 mg/L TH < 35 °F if chemical treatment)
TAC (alkaliniteti total)	TA < 40 °F - 400 mg/L
Ca ²⁺	TA < 40 °F - 400 mg/L
Mg ²⁺	mg/L (the lowest possible)
Fe ²⁺	mg/L (the lowest possible)
Mn ²⁺	Fe ²⁺ < 3 mg/L
CO ₃ H ⁻ (Bikarbonate)	mg/L
Cl (klorur)	mg/L
SO ₄ ²⁻ (Sulfate)	Cl < 2.000 mg/L (the lowest possible)
MASHT (Totali i lëndëve të ngurta të pezulluara)	SO ₄ < 250 mg/L
FI (Kapaciteti bllokues)**	MEST < 100 mg/L
Fraksioni organik	FI < 3
Fraksioni mineral	mg/L
Nxehtësia e mbetur 110 °C	mg/L
TH (Fortësia totale)*	mg/L

Vëllimi minimal i ujit që kërkohet për analizë = 1.5 L

Karakteristikat

- Qarku i ujit duhet të jetë qark i mbyllur.
- Vendosni një filtër nominal aktiv 20 µm (50 µm absolut) në hyrje të makinës në mënyrë që të projektoni makinën kundër grumbullimit të grimcave të ngurta nga tubacionet ose ndotjes aksidentale nga makineritë e tjera në linjë.

Cilësia e ajrit - Ajri i ofruar nga blerësi do të jetë në përputhje me cilësinë si më poshtë:

➤ Quality of Air				
Pluhuri i mbetur		Uji i mbetur		Vaj i mbetur
µm	mg/m ³	DTP[C]	g/m ³	mg/m ³
0,1	0,1	-70	0,003	0,01

SHPËLARJE - MBUSHJE - MBYLLJE



Figura 11. Makinaria Shpëlarje - Mbushje - Mbyllje.

Fotografia është vetëm për qëllime ilustrimi dhe nuk përputhet me kusht me makinën e dhënë;

- shpëlarës rrotullues plotësisht automatik, mbushës dhe kapak i projektuar dhe prodhuar posaçërisht për shpejtësinë e përmendur;
- Parimi i mbushjes: mbushja me gravitet;
- parandaloni tejmbushjen;
- Shumë precize;
- Korniza: çelik inox AISI304;
- Të gjitha sipërfaqet që kontaktojnë me produktin janë inox AISI316;

- Pa shishe – pa sistem mbushjeje;
- Filtër Hepa me mbulesë plotësisht të mbyllur;

Trajtimi;

- Trajtimi i kontejnerit nga qafa;
- Kontejneri i lëshuar në një transportues me furnizim me sistem të rregullueshëm lartësie, moduli capping (ersey capper);



Figura 12. Makina e kapakut.

Për një lloj dhe format specifik të kapakut, çdo konfigurim tjetër dhe pajisjet e tij janë të ndara dhe citohen si opsione;

- ✓ Sistemi i ngritjes dhe orientimit të kapakut;
- ✓ për çdo konfigurim tjetër dhe pajisjet e tij janë të ndara dhe të kuotuar si opsione;
- ✓ Pa shishe – pa sistem tapash;

Etiketuesi Linear Opp




Figura 13. Makina e etiketimit.

Makina e etiketimit linear është në gjendje të aplikojë mbështjellësin rreth etiketës letre në trupin e shisheve PET nëpërmjet teknologjisë së ngjitësit të nxehtë.

Përshkrim - Makinë automatike lineare për etiketimin e ngjitësit të nxehtë me rrotulla për aplikimin e etiketave të plota të mbështjella me rrotull në enë plastike

- Dizajn linear për trajtim më të lehtë;
- dizajni kompakt i mundëson operatorit të kontrollojë të gjitha proceset e etiketimit;
- Procedura të thjeshta ndërrimi dhe mirëmbajtjeje;
- Më pak përshtatje;
- Cilësimet e thjeshta të etiketave transferojnë parametrat e kazanit;
- Cilësime të thjeshta të parametrave të prerjes së etiketave;
- Rregullime nëpërmjet HMI;
- Mbështetje me rrotulla;
- Rul ushqimor;
- Moduli i prerjes;
- HMI e integruar për të gjitha operacionet, duke përfshirë regjistrimin/prerjen e etiketave;



- Kazan me vakum transferues;
- Moduli i aplikimit të ngjitësit me shkrire të nxehtë;

Tabela 5. kapaciteti i paketimit te shisheve për minuta.

MASDHESIA E SHISHEVE	GRUPIMI I SHISHËVE NË PAKETIM	1 MINUTE/KAPACITETI	Shishe 1 ORË/ NUMRI I SASISË
1-1,5lt	2*3=6 shishe	27-30 PAKO NË MINUTE	11.000 shishe në orë
1-1,5lt	3*4=12 shishe	27-30 PAKO NË MINUTE	22.000 shishe në orë
500ml	3*4=12 shishe	27-30 PAKO NË MINUTE	22.000 shishe në orë
500ml	4*6=24 shishe	27-30 PAKO NË MINUTE	38.880 shishe në orë
0,330ml	4*6=24 shishe	27-30 PAKETA NË MINUTE	38.000 shishe në orë
0,330ml	2*4=12 shishe	27-30 PAKO NË MINUTE	22.000 shishe në orë

Koduesi i datës Laserët - Makinë klasike automatike paletizuese dhe mbështjellëse.



Figura 14. Koduesi i datës Laserët

Tabela 6. Te dhënat e makinë klasike automatike paletizuese dhe mbështjellëse.

Technical Details	
Model	EP 100
Dimensionet e paletës	Euro pallets 800 x 1200 mm Local pallets 1000 x 1200 mm
Kapaciteti	2000 Packet/ hour, 24.000 – 34.000 bottle / hour
Lartësia e plotë e paletës	0,5 lt – 8 fold – 1870 mm
Lartësia e paletës	150 mm
Tensioni	220 – 380 V 3 phase 50 Hz
Tensioni i kontrollit	24 V
Kontrolli	SERVO,PLC
Konsumi i energjisë	6 kW
Pesha e trupit	5.000 kg.
Dimensionet e trupit	7800 mm x 8650 mm x 4770 mm
Materiali i trupit	St42- 37 Fe, DTM 7025** paint

Makinë mbështjellëse me shtrirje.



Figura 15.Makinë mbështjellëse me shtrirje.

Fotografia është vetëm për qëllime ilustrimi;

- Makinë me krah rrotullues me për formancë të lartë për mbështjelljen e paletave me film shtrirje
- Ndërtim i besueshëm, i fortë



- Fleksibilitet në prodhimin, produktet dhe paraqitjen Mbështjellësi rrotullues i paletës së krahut
- Rrotullat e drejtuara me kontroll elektronik të zbulimit të fotocelës
- Ndërfaqja e përdoruesit të kornizës bazë
- Sistemi i ngritjes së paletave
- Mbarimi me shtrirje, prerja, sistemi i ngjitjes Sistemi i ndryshimit të zgjatjes së shpejtë
- Sistemi i kontrollit të sigurisë Barrierat e sigurisë

Transportues ajri

- Për shishet plastike bosh
- Drejtë, kurbë
- Udhëzues i qafës
- Filtrimi
- Kapëse udhëzuese nën qafë
- Dizajn higjienik

Fotografia është vetëm për qëllime ilustrimi



Figura 16. Fotografia është vetëm për qëllime ilustrimi.

Transportues shishe

Komplet transportues shishe çeliku inox sipas planit;

Korniza, mbështetësit, këmbët dhe komponentët e bërë prej çeliku inox AISI 304 gamë e gjerë rripash, Kornizë e lakuar, Kornizë transferuese.




Figura 17. Model - Transportuesi i Shisheve.

Meqenëse kapaciteti për orë është 1200 -2000 në linjën PET 5/10 L, është zgjedhur një makinë lineare fryrjeje. Në sistemin linear të fryrjes, paraformat mbushen në njësinë e ushqimit dhe me ndihmën e njësise ushqyese të paraformës, paraformat përcillen në furrën e ngrohjes pa probleme dhe vazhdimisht. Furra ka gjithashtu një sistem ventilimi për ftohjen e qafës së paraformës dhe sipërfaqes së paraformës. Paraformat e nxehta transferohen në presën fryrëse me sistemin servo dhe shishet që dalin nga presa fryrëse dërgohen në makinën mbushëse me anë të transportuesit.

4.2.Kapaciteti i objektit dhe krahasimi i tij me objektet e tjera

Kapaciteti prodhues i fabrikës do të jetë 190 milionë litra/vit që do të jetë mjaftueshëm i lartë për të mbuluar kërkesën e tregut të Kosovës dhe do të ketë kapacitet shtesë për tregjet e eksportit (Ballkan, MB, Austri, Itali, Francë, Kuvajt, Arabi Saudite, Katar , Emiratet e Bashkuara Arabe).

Mesatarisht, në Kosovë shiten 130 milionë litra ujë në shishe në vit. 40 milionë litra furnizohen nga prodhuesit vendas, 90 milionë litra importohen.

Pra, objekti ynë do të synojë rreth 60% të prodhimit të tij për tregun vendas dhe 40% për tregjet e eksportit.

Lista e makinerive dhe pajisjeve:

Lista e makinerive dhe pajisjeve që do të instalohen me projektin është dhënë në tabelën 7 më poshtë.



Tabela 7. Makineri dhe pajisje 8C2 0,5 lt Lista e pajisjeve të linjës.

No	Përkufizimi: Linja e mbushjes së ujit të shisheve PET, Kapaciteti nominal 12,000 shishe/orë @ 0,5 L 9000 shishe/orë @ 1,5 L Efikasiteti i linjës 90%	Piece / mt
1	BLW8C2-SRV Dizajni i kallëpit dhe shisheve të makinerisë për derdhje PET PET (500cc & 1500cc)	1
2	Preform Ashensor	1
3	Ashensor i kapakut të makinës shpëlarëse-mbushëse-mbytëse në monoblog	1
4	Kufoma e plotë e mbyllur + Filtri Hepa	1
5	Makinë etiketimi me ngjitës të nxehtë OPP OLM	2
6	Shrink Packaging	30 m
	Komplet ekstra të barkut dhe daulleve (330cc & 1000cc)	57 m
	Transportues Ajror	36 m
7	Transportues ndërmjet mbushjes dhe etiketimit	1
8	Transportues ndërmjet etiketimit dhe tkurrjes	1
9	paletizues	15 m
10	Stretch Wrap	1
11	Transportues paketimi	1

Tabela 8. Lista e pajisjeve të linjës 2c10 5 lt.

No	Përkufizimi: Linja e mbushjes së ujit të shisheve PET, Kapaciteti nominal 2,000 BPH @ 5 L Efikasiteti i linjës 90%	Piece/ mt
1	BLW2C10-SRV Dizajni i mykut dhe shisheve të makinerisë së derdhur me fryrje PET	1
2	Preform Ashensor	1
3	Ashensor i kapakut të makinës shpëlarëse-mbushëse-mbytëse në monoblog	1
4	Kufoma e plotë e mbyllur + Filtri Hepa	17 m
	Makinë etiketimi me ngjitëse	17 m
5	Fryrje dhe mbushje transportues	1
6	Transportues Plotëso & Etiketë	1



Tabela 9. 0,33-0,75 linja e çmimeve dhe lista e pajisjeve të shisheve të qelqit të gazuar.

No	Përkufizimi: Linja mbushëse e shisheve të qelqit të gazuar, Kapaciteti nominal: 10,000 BPH @ 0,33 L 9,000 BPH @ 0,75 L Efikasiteti i linjës 90%	Piece / mt
1	Depaletizues	1
2	Ashensori i Mbulesës së Makinerisë Shtundëse-Mbush-Mbushëse me vidë në monoblog	1
3	Kufoma e plotë e mbyllur + Filtri Hepa	1
4	Makinë etiketimi me ngjitëse (2 copë)	1
5	Makinë për vendosjen e datës me bojë	1
6	Makinë për turrje të panit	1
7	Parapërzjerje dhe shkëmbyes nxehtësie (7 ton/orë)	60 m
	Depaletizues dhe transportues ndërmjet mbushjes	85 m
	Transportues ndërmjet mbushjes dhe etiketimit	65 m
	Transportues ndërmjet etiketimit dhe turrjes	20 m
8	Transportues paketimi	1
	Paletizues	1
9	Stretch Wrap	1

4.3. Llogaritja e sasisë së nevojshme të ujit për prodhim dhe nevoja tjera të kompanisë

Kompania “ANAHITA”SH.P.K. ka planifikuar që për nevoja të mbushtores dhe ambalazhimit të ujit të kyçet në gypin ekonomik i cili është ndërtuar nga Komuna e Istogut në pikën me koordinata si në ortofoton dhe hartën topografike të mëposhtëm:




Figura 18. Ortofoto dhe harta topografike e pikës së kyçjes në burim.

Në kompani është planifikuar të punohet orar të caktuar me kohë pune prej $t_{unës} = 10$ orë/ditë ku për këtë, do të llogaritet kërkesa për ujë për dy kategoritë mëposhtme të përdorimit të ujit siç janë:

- Shfrytëzimi i ujit për mbushtore – ambalazhim,
- Shfrytëzimi i ujit për nevojat e kompanisë dhe administratës si dhe
- Shfrytëzimi i ujit për pastrim të makinerive të ambalazhimit.

4.4. Llogaritja e sasisë së ujit për ambalazhim dhe mbushtore

Duke u bazuar në të dhënat nga investitori si dhe në specifikat e makinerive kemi sasinë e shpenzimit për mbushtore dhe ambalazhim të ujit si në vijim:

- Kapaciteti prodhues i fabrikës do të jetë 190 milionë litra/vit,



Shfrytëzimi maksimal për ambalazhim dhe mbushtore do të jetë:

$$Q_{\max} = 190 \text{ mil.lit/vit} = 190,000 \text{ m}^3/\text{vite} / 300 \text{ dite/vit} = 633.33 \text{ m}^3/\text{dit} = 17.60 \text{ l/s}$$

$$Q_{\text{vjet.max}} = 190,000.00 \text{ m}^3/\text{vit}$$

4.5. Sasia maksimale e shfrytëzimit të ujit për administratë

Duke u bazuar në numrin e planifikuar të punëtorëve mund të llogarisim edhe sasinë maksimale të shfrytëzimit të ujit për nevojat e administratës:

Kompania sa për fillim ka planifikuar të punësojë rreth 12 punëtor

Kapaciteti i shfrytëzimit 60 lit/dit.punt

$$Q^d = N_p * n_1 = 12 * 60 = 720 \text{ lit/ditë}$$

$$Q^o_{\text{mes}} = Q^d_{\text{maks}} / t_{\text{punës}} = 720 / 10 = 72 \text{ lit/orë}$$

$$q^{s,k}_{\text{maks}} = Q^o_{\text{maks}} * 1000 / 3600 = 72 / 3600 = 0.020 \text{ l/s}$$

Furnizimi me ujë sanitar për nevojat të stafit dhe punëtorëve është planifikuar që të bëhet nga sistemi i ujësjellësit. Kompania "ANAHITA" SH.P.K. gjatë vitit punon mesatarisht 300 ditë, e cila shfrytëzon sasinë max. prej 0.020 l/s, që do të thotë se kjo kompani brenda vitit shfrytëzon sasi të ujit për punëtor:

Sasia maksimale e shfrytëzimit të ujit për punëtor brenda vitit:

$$Q_{\text{vjet}} = q^{s,k}_{\text{maks}} * 300 \text{ ditë/vit} = 0.020 \text{ l/s} * 300 \text{ ditë/vit} * 1/1000 \text{ m}^3/\text{s} * 10 \text{ h/dite} * 60 \text{ min./h} * 60 \text{ s/min.} = 216.0 \text{ m}^3/\text{vit.}$$

Në kompani është planifikuar të punohet orar të caktuar me kohë pune prej $t_{\text{unës}} = 10$ orë/ditë ku për këtë, do të llogaritet kërkesa për ujë për dy kategoritë mëposhtme të përdorimit të ujit siç janë:

- Shfrytëzimi i ujit për mbushtore – ambalazhim;
- Shfrytëzimi i ujit për nevojat e kompanisë dhe administratës;



Skema e procesit teknologjik




Figura 19. Skema e procesit teknologjik.

4.6. Karakteristikat e objektit ku do te vendoset linja e fabrikës se ujit

Objekti ku do te vendoset fabrika për mbushjen e shisheve, është i pajisur me leje ndërtimore nga komuna e Istogut.

Sipërfaqja totale e objektit është 9099 m² dhe është parapa te shfrytëzohet ne baze te nevojave te kompanisë si;

- Pjesa e vendosjes se linjës se prodhimit
- Pjesa e administratës
- Pjesa e shishëve te mbushura me ujë



Figura 20. Skica e objektit.



Figura 21. Foto e objektit te ndërtuar.



5. NDIKIMET NE MJEDIS

Në këtë kapitull, informacioni mbi vlerësimin e ndikimeve mjedisore dhe sociale është i organizuar në nën-kapituj për secilin burim/receptor mjedisor të ndikuar. Qëllimet e procesit të identifikimit dhe vlerësimit të ndikimit janë:

- Identifikoni ndikimet e mundshme negative dhe të dobishme mjedisore dhe sociale bazuar në njohuritë e regjimit të ndërtimit dhe funksionimit të projektit dhe informacionit bazë në Zonën e Studimit.
- Vendosen propozime të projektimit për të lehtësuar ndikimet e pafavorshme dhe për të rritur ndikimet e dobishme.

Ky identifikim dhe vlerësim i ndikimit u bazua në kërkesat e ligjeve të Kosovës. Opinionet e palëve të interesuara të marra gjatë aktiviteteve të angazhimit janë marrë gjithashtu në konsideratë.

Duke i pasur parasysh specifikat e projektit ndikimet ne mjedis mund të ndodhin vetëm për gjatë zhvillimit të procesit teknologjik, prandaj të gjitha ndikimet e mundshme negative ne mjedis i klasifikojmë si:

- ndikimet gjatë fazës së përdorimit të pajimeve;
- ndikimet gjatë fazës pas ndërprerjes së punës dhe përdorimit të pajimeve;
- ndikimet në raste aksidentale nga avarit të ndryshme;

Në lokacionin e planifikuar për vendosjen e linjës së prodhimit ndikime ne mjedis mund të ketë nga procesi teknologjik i prodhimit. Ndikime të mundshme në ujë, ajër dhe tokë – zonën përreth. Projekti do të kujdeset që këto ndikime të jenë të përmasave të pranueshme për mjedisin, sipas standardeve - limiteve të lejuara.



5.1.1. Ndikimet në mjedis - gjatë operimit

Ndikimet negative potenciale ne mjedis mund të shprehen si:

- ❖ ndikime ne kualitetin e ajrit
- ❖ ndikime ne kualitetin e ujit
- ❖ ndikime ne tokë
- ❖ ndikimet e zhurmës ne mjedis
- ❖ ndikimet ne florën dhe faunën
- ❖ ndikimet ne mikroklimë

Ne vijim do të analizohen të gjitha ndikimet potenciale ne mjedis.

5.2. Ndikimet në ajër

Intensiteti i ndikimeve ne ajër varet nga procesi teknologjik i secilës veprimtari prodhuese, lëndës së parë, kushteve klimatike dhe karakteristikave geomorfologjike të ternit. Në kualitetin e ajrit në hapësirat punuese dhe në rrethinën e fabrikës mund të ndikojnë:

- ❖ pluhurit i cili lirohet gjatë lëvizjeve te makinerive transportuese;
- ❖ gazrat të cilët lirohen gjatë punimeve te makinerive transportuese;
- ❖ ne raste te shfrytëzimit te ndonjë gjeneratori për prodhimin e energjisë; .

5.3. Ndikimet në ujë

Ndikimet ne ujera sipërfaqësore mund të ndryshojnë si rezultat i aktiviteteve të projektit, gjatë fazave të operimit.

Me projekt të hidroinstalimit është paraparë që furnizimi me ujë të bahet nga mënyra vetanake. Në procesin teknologjik për prodhimin apo mbushje te shishëve me ujë, nuk kemi shkarkime nga procesi teknologjik te uji, dhe prandaj nuk do të kemi ujera të ndotura industriale.

Në hapësirat e fabrikës mund të ketë ndotje gjate fazës se operimit, te cilat janë:

- ujera të ndotura nga larja e mekanizmit të lartë dhe pastrimi i hapësirave punuese;
- ujërat e ndotura sanitare dhe fekale, (faza e operimit);
- ujërat nga sipërfaqet manipuluese;
- rrjedhje dhe derdhje aksidentale të karburantit, lubrifikantëve dhe substancave të tjera të rrezikshme në zonat e depozitimit të produkteve dhe mbeturinave;



- ujërat e ndotura nga sipërfaqet e hapësirave të servisimit të makinave dhe kamionëve transportues;

Ujërat e liruara të cilat janë përdorur për larjen e mekanizmit, hapësirave rreth pajimeve, hapësirave për deponim dhe kamionëve transportues, përmbajnë papastërtia mekanike dhe vajra e yndyra.

Këto ujera janë mjaftë të turbullta dhe të yndyrshme, prandaj ndikojnë në ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

5.4. Ndikimet në tokë

Toka si element themelor natyror është kusht ekologjik për rritjen dhe ekzistimin e bimëve, toka është element për prodhimin e ushqimit dhe ekzistimin e ekosistemit malor të cilët janë të nevojshëm për arritjen dhe mbajtjen e bilancit ekologjik (produkimit dhe ndërtimit të materieve), posaçërisht për mbajtjen e stabilitetit mjedisor. Toka është e domosdoshme edhe për funksione teknike në këtë rast për fabrikën e ujit.

Në aspektin e ndotjes së dheut dallojmë dy faza edhe atë periodën gjatë ndërtimit dhe periodën gjatë operimit.

Fazën e operimit - në fazën e operimit, ndotja e dheut mund të ndodhë si pasojë e ndonjë rrjedhje të derivateve nga makineritë transportuese.

Këto ndotje të dheut evitohen vetëm me largimin e dheut apo pastrimit të hapësirës të kontaminuar dhe transportimin e tij në vendet e caktuara aty ku nuk rrezikojnë mjedisin.

5.5. Ndikimet e zhurmës në mjedis

Me termin zhurmë nënkuptojmë çdo tingull në nivelin e caktuar me ligj. Zhurma krijohet nga automjetet transportuese, mekanizmit dhe pajimeve gjatë punës, gjatë fazës së operimit.

Koha e veprimit të zhurmës është në funksion të angazhimit të pajimeve, gjegjësisht orarit të punës. Në lartësinë e zhurmës ndikojnë rrjetat e pa forcuara dhe të dëmtuara, lidhëset filetove, saldimet e pëlcitura, mos lubrifikimi i kushinetave, vibrimet e sitave, shtrëngimi jo i rregullt i lidhëseve (rrypav) etj.

Për arsye të zvogëlimit të nivelit të zhurmës në përpunueshmëri me mundësitë teknike duhet në mënyrë kontinuele të përcillen këto burime potenciale të krijimit të zhurmës.



Zhurma, si element në teknologjinë e prodhimit ka një karakter lokal dhe pa ndikim në zonat e banuara. Në këtë rast vendbanimet janë në distance të konsiderueshme.

Zhurma vjen si rezultat i aktivitetit të procesit teknologjik, nga makinat gjatë procesit të ngarkimit, transportit, mirëpo për shkak të pajimeve teknologjike dhe atyre transportuese e ngarkuese që janë prodhime të reja niveli i zhurmës është nën kufijtë e lejuar me standarde. Me shfrytëzimin e pajimeve prodhuese në bazë të standardeve të zakonshme maksimumi i zhurmës në burim është 90 dB. Zhurma për zonën e banuar është plotësisht në kufijtë e standardit dhe gjatë ditës nuk do të kalojë 50 dB, kurse gjatë natës gjithashtu nuk do të tejkalojë nivelin 45 dB.

Tabela 10. Pasqyrë tabelore e nivelit të zhurmës në varshmëri nga distanca

Zhurma	Distanca (m)			
	10	50	100	500
90db -niveli Për pajisje moderne	59	45	39	25

5.6. Ndikimet në florë dhe faunë

Sipas gjendjes faktike në terren respektivisht në lokacionin ku është nderuar objekti i kompanisë nuk do të kemi keqësim shumë të madhe të apo zhdukje të mëdha të vegjetacionit pos nga sipërfaqet nën objekte dhe nën hapësirat punuese kjo do të thotë se kemi të bëjmë me koncentracion të vogël të polutantëve. E njëjta do të vlenë edhe për faunën që do të thotë se nuk pritet të ketë ndikime të mëdha negative në faunën, që do të thotë se nuk kemi zhdukje të faunës, përveç largimit të faunës nga rrethina e ngushtë e lokacionit të lartpërmendur.

5.7. Ndikimet në mikroklimë

Zhvillimi i procesit teknologjik për prodhimin kryhet në kushtet mjedisore të temperaturës dhe ajrit, prandaj nuk do të ketë ndikime të konsiderueshme në ndryshimet mikroklimatike, në rrethin të ngushtë dhe të gjerë për arsye se emisionet e nxehtësisë janë të pa përfillshme. Gjatë procesit teknologjik të prodhimit nuk do të ketë shkarkime të gazrave në atmosfere të cilët mund të ndikojnë në mikroklimën.



5.8. Ndikimet në peizazh

Ndikimet e parashikuara në peizazh do të vijnë nga prania e elementëve të rinj që do të ndryshojnë peizazhin, qoftë përkohësisht ose përgjithmonë. Ndryshimet e përkohshme në përgjithësi do të shoqërohen me praninë fizike të punëtorëve dhe makinerive dhe objektit i cili është ndertuar, me ç'rast ndikimet e përhershme do të shoqërohen me elementët strukturorë të ndërtuar të objekteve. Efektet në peizazh fillojnë në fazën e ndërtimit, por ato vazhdojnë gjatë fazës së funksionimit.

Në këtë pjesë, ndikimet gjatë fazës së ndërtimit i referohen atyre që kanë karakter të përkohshëm. Ndikimi afatgjatë në peizazh analizohet si pjesë e fazës së funksionimit.

5.9. Ndikimet në mjedis pas fazës të mbylljes

Ndikimet negative në mjedis në fazën pas mbylljes mund të ndodhin vetëm në raste se nuk trajtohen në mënyrë adekuate mbeturinat e vrazhda që dalin gjatë fazës së demolimit të objektit.

Në këtë mënyrë mund të vij gjerë te ndotja e tokës dhe ujërave eventuale sipërfaqësore dhe nëntokësore varësisht nga lloji i këtyre mbeturinave.



6. MASAT PËR ZBUTJEN E NDIKIMEVE NË MJEDIS

Ne këtë kapitull është kryer analiza dhe janë përshkruar masat për parandalimin, zvogëlimin ose zbutjen e ndikimeve negative të fabrikës. Masat e përgjithshme të propozuara për zbutjen e ndikimeve negative.

Me qëllim që të parandalohen, shmangen, minimizohen dhe kontrollohen ndikime negative mjedisore të projektit gjatë fazës së ushtrimit të tij duhet të merren masat e duhura nga kompania.

Lloji i masave për mbrojtjen e mjedisit që do të merren ndahen në:

- Teknike dhe
- Organizative

Tabela 11. Paraqitja tabelore e masave teknike dhe organizative

Çfarë	Si
Parandalim	- Përzgjedhja e teknologjisë me cikël të mbyllur në pajtueshmëri me ligjet mjedisore - Instalimi korrekt i makinave - Përzgjedhja dhe trajnimi i personeli për mënyrën e përdorimit të teknologjisë - Zbatimi rigoroz i sigurimit teknik gjatë punës dhe ndërprerjes së saj - Përdorimi i naftës me cilësi të lartë
Kontroll	- Sigurimi i të gjitha pajisjeve të nevojshme për riparim, pastrim dhe ndërhyrje në raste emergjencash. - Lagia e sheshit të punës dhe rrugëve nëpër të cilat kalojnë kamionët - Lëvizja e ngadalte e automjeteve - Larja e shpeshtë e makinerive dhe kamionëve të punës
Ndërhyrje	- Riparimi i menjëhershëm i defekteve dhe avarive teknologjike imitimesh dhe derdhjes të paparashikuara - Pastrimi i menjëhershëm i derdhjes aksidentale - Njoftimi i menjëhershëm i autoriteteve dhe njësive të specializuara në rast emergjencash (zjarrfikës, ambulanca).
Administrim	- Përdorimi dhe ruajtja me përgjegjësi të të gjithë infrastrukturës dhe makinave sipas rregullave teknologjike.



Zvogëlimi ose zbutja e ndikimeve negative në mjedis në princip arrihet duke i u përmbajtur masave themelore si në vijim:

- zvogëlimi i emisioneve të materieve negative në atmosferë gjatë realizimit të procesit teknologjik;
- trajtimi dhe pastrimi i ujërave të ndotura nga larja e makinerive dhe pastrimi i hapësirave punuese;
- trajtimin e ujërave të ndotur sanitaro;
- zvogëlimi i emisionit të zhurmës;
- monitorimin mjedisor;
- përdorimi i masave tjera organizative, tekniko-teknologjike të cilat janë në funksion të mbrojtjes së mjedisit;

Me zbatimin e masave për mbrojtjen e mjedisit nga ky raport, të dokumentacionit projektues dhe akteve ligjore dhe nënligjore mjedisore, do të arrihet që pajimet për prodhimin me objektet përcjellëse në këtë lokacion nuk do të ketë ndikime negative në mjedis dhe kushtet mjedisore nuk do të për keqësohen, gjegjësisht mjedisi nuk do të ndotet mbi vlerat standarde dhe kërkesave të përcaktuara për mbrojtjen e mjedisit në këtë raport.

6.1. Masat për mbrojtjen e ajrit

Në kushtet e udhëheqjes së procesit teknologjik sipas normave të projektuara dhe me kontroll të mirëfilltë të pajisjeve për transport nuk ekziston rreziku që ndotja e ajrit të jetë mbi vlerat maksimale të lejuara të materieve ndotëse të caktuara si pas Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2021 mbi rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes dhe normave të caktuara nga legjislacioni vendor dhe i BE.



6.2. Masat për mbrojtjen e ujit

Ne procesin për prodhimin nuk lirohen ujera të ndotura teknologjike, por ndotja ndodh si që e kemi përshkruar mësipërme, prandaj duhet ndërtuar kolektorët për grumbullimin dhe sistemin gypor për bartjen e ujërave të ndotura nga tëra sipërfaqet punuese të fabrikës, duhet të dërgohen për trajtim në separatorin për pastrimin e ujërave të ndotur me grimca të ngurta dhe me vajra e yndyra të ndryshme që rrjedhin nga makineritë që lëvizin mbi pllato.

Separatori duhet ndërtuar sipas standardeve dhe në bazë të përmasave dhe përshkrimit të dhënura në projektin kryesor të ndërtimit të objektit ku është pajisur me leje ndërtimore nga komuna e Istogut.

Ujërat nga separatori dhe gropa septike nuk guxojnë të lëshohen në recipient apo të derdhen në natyrë pa u trajtuar nëse përmbajnë vajra dhe yndyra mbi 1mg/l dhe materie të suspenduara mbi 30mg/l në ujë.




Figura 22. Skema teknologjike e ujrave

Ujërat nga separatorët dhe gropa septike nuk guxojnë të lëshohen në recipient apo të derdhen në natyrë pa u trajtuar nëse përmbajnë vajra dhe yndyra mbi vlerat e përcaktuara me Udhëzim administrativ për vlerat kufizuese të efluentit që shkarkohet në trup ujorë dhe në rrjetin e kanalizimit publik.



Po ashtu edhe ujerat fekale kompania planifikon te i shkarkoj ne rrjetin e kanalizimit te qytetit, pasi qe ky rrjete është i shtrire deri ne afërsi te parcelës ku ndërtohet impianti.

6.3. Masat për mbrojtjen e tokës

Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në tokë gjatë fazës së operimit të fabrikës duhet të merren këto masa:

- Për mbrojtjen e tokës nga ndikimet negative te tëra hapësirat punuese ne të cilat bëhet manipulimi me karburante duhet të mbulohen me beton ose me kocka.
- Duhet të vendosen kontejnerët adekuat të pajisur me kapak për deponimin e mbeturinave komunale, dhe enët adekuate për deponimin e mbeturinave të lënget.
- Bitumeni i derdhur ne mënyrë të papritur duhet të mblidhet dhe kthehet ne prodhim (riciklim).
- Të bëhet përdorim i drejt, mbikëqyrje e rregullt dhe mirë mbajtje e pajisjeve.
- Të hartohet rregullorja ku do të definoohen procedurat për rastet aksidentale, të bëhet aftësimi i të punësuarve dhe të caktohen obligimet e tyre në situata aksidentale.
- Duhet të bëhet mbjellja e sipërfaqeve dhe oazave të pa betonuara dhe asfaltuara me barë dhe druaj dekorativ me qëllim të pastrimit të ajrit nga ndotjet me gazra, dhe për çështje vizuale.

6.4. Masat për mbrojtjen nga zhurma

Duke pasur parasysh procesin teknologji dhe objekti i cili është ndërtuara me standardë te larta zhurma si element ndotës do te minimizohet ne suazat e lejuara dhe nuk do ti pengoj banorët qe janë afër fabrikës.



Mire po gjate fazën e funksionimit - Duhet të bëhen matjet e zhurmës në përputhje me ligjet dhe rregullat mbi mbrojtje nga zhurma. Matjet duhet bërë në afërsi të objekteve të banimit. Për analizat dhe vlerësimin e rezultateve të fituara nga matjet duhet ti' krahasojmë me vlerat e lejuara me standarde për vendet ku jetojnë dhe punojnë njerëzit.

Në rast se zhurma e mesit nga matjet tejkalon at të lejuarën atëherë duhet të merren të gjitha masat që niveli i zhurmës të bihet në nivelin e lejuar sipas rregullave në fuqi. Në varshmëri nga fazat e procesit të prodhimit duhet edhe të punësuarit në ato vende të punës të përdorin mjetet kundër zhurmës.

6.5. Masat për mbrojtjen e florës dhe faunës

Sipas analizave të bëra deri tani në lidhje me ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës mundë të vije deri te ndikimet në florë dhe faunë.

Vegjetacioni po thuhet se ne tersi humbet kur ndërtohen objektet industriale, nga sipërfaqet nën objektet përcjellëse dhe nën platonë e hapësirës punuese.

Sipërfaqet e lira të ngastrës për rreth objektit do të mbillen me bimë dhe druje dekorativ. E njëjta do të vlente edhe për faunën që do të thotë se nuk pritët të ketë ndikime negative.

Kompanisë i epet urdhëresë e që të mos deponoj pa kontroll mbeturina në vende të ndryshme por ato duhen të deponohen në vende me destinimit të caktuar.

6.6. Rastet aksidentale

Kompania duhet të bëhet planin e intervenimit për raste të aksidenteve. Duhet te merren një seri masash:

- Duhet të bëhet plani i mbrojtjeve nga zjarri.
- Duhet i tërë oborri të thuret me tel gjembor.
- Të merren të gjitha masat për evitimin e derdhjes së derivateve të naftës dhe vajit nga makinat transportuese.



- Kompania duhet të jetë e pajisur me pajime kundërzjarri, të ketë mundësi alternative të portave hyrje dalje.
- Në raste të lajmërimit të zjarrit menjëherë të merën masa për neutralizimin e tij. Pajisjet kundër zjarrit duhen të ruhen në mënyrë të veçantë.
- Të merën të gjitha masat e sigurisë konform ligjit për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe mjedisit të punës.
- Të hartohet rregullorja ku do të definohen procedurat për rastet aksidentale, të bëhet aftësimi i të punësuarve dhe të caktohen obligimet e tyre në situata aksidentale.

7. MONITORIMI I MJEDISIT

Ndikimet direkte nga aktiviteti i fabrikës, bazuar në vlerësimet e ndikimit në mjedis janë ndikimet në tokë, ajër dhe ujë por jo të jenë te pritshme mbi limite të lejuara.

Monitorimi duhet të përfshijë kontrollin e rregullt vizuale të hapësirës, gjegjësisht kufizimin e emisionit të grimcave të pluhurit në atmosferë. Këto ndikime janë relativisht minimale në mjedis pas marrjes së masave për zvogëlimin e këtyre ndikimeve, dhe si të tilla mund të monitorohen. Për këtë arsye parashihet një program monitorues për të gjitha shkarkimet.

Monitorimi i ajrit dhe ujit duhet të bëhet në perioda të caktuara periodike në konsultim me ekspert të kësaj lëmie dhe të jenë të pranueshme nga MMPHI, Agjensioni Kombëtar i Mbrojtjes së Mjedisit – ku edhe duhet të raportohen të dhënat, ky monitorim realizohet me marrjen e mostrave dhe kryerjen e analizave në institute adekuate.

Kontrolli i mundshëm i kontaminimit të tokës dhe verifikimi i nivelit të zhurmës dhe vibracionit po ashtu duhet të realizohet dhe të raportohet tek kompetentët.

8. RAPORTIM



Duhet te kryhet nga udhëheqja, gjegjësisht nga ekspertët e kompanisë së paku në fund të çdo viti kalendarik, ku do t'i paraqiten të dhënat relevante nga të gjitha monitorimet e bëra brenda vitit, të cilat do të raportohen autoriteteve përkatëse të MMPHI sipas kërkesës së tyre dhe komunitetit lokal brenda komunës.

9. MASAT REHABILITUESE PAS PËRFUNDIMIT TË AKTIVITETIT

Problematika e shfrytëzimit të tokës bujqësore për nevoja jobujqësore është rregulluar me Ligj dhe akte nënligjore. Sipas Ligji nr. 08/1-112 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 02/1-26 për tokën bujqësore, me rastin e ndërrimit të destinimit të tokës për nevoja të eksploatimit të mineraleve. Ndërrimi i përkohshëm i destinimit të tokës bujqësore konsiderohen objektet e karakterit të përkohshëm, shfrytëzimi i mineraleve sipërfaqësore, depozitë e mbeturinave, hirit industrial dhe mbeturinat e industrisë së drurit. Toka bujqësore pas një periudhe të caktuar përsëri mund të shfrytëzohet për prodhimtari bujqësore.

Rikultivim i tokës bujqësore. Toka bujqësore e cila është shfrytëzuar për destinimit tjetër, e cila nuk ka karakter të përhershëm, i kthehet destinimit të parë apo destinimit tjetër, përkatësisht aftësohet për prodhimtari bujqësore sipas projektit për rikultivim. Pëlqimin në projektin për rikultivim e jep organi kompetent komunal për bujqësi.

9.1. Objektivat e rikultivimit

Pas përfundimit të aktivitetit të fabrikës (kjo varet nga kërkesa e tregut dhe gjendja teknike e pajimeve). Pas këtij afati pajimet duhet të çmontohen e të vendosen në një lokalitet tjetër apo në bazë të leverdis së kompanisë të shitën si material i vjetruar. Bazamentet si dhe platot nga betoni të shkatërrohen, imtësohen dhe të dërgohen në deponi përkatëse.



Nga proceset teknologjike të prodhimit do të krijohen substrate që i takojnë kategorisë së tokave të dëmtuara d.m.th. substrate të pa përshtatshme (sterile) për rikultivim. Substrate me përbërës granulat, që pa tjetër duhet të largohen dhe bëhet zëvendësimi i tij me at të rrethit ashtu që të krijohet një substrat produktiv i përshtatshëm për rikultivim.

Rikultivimi i këtyre sipërfaqeve të dëmtuara përfshin rivitalizimin në tërësi të hapësirave të dëmtuara nga realizimi i projektit. Zgjedhja e modelit të rikultivimit varet nga:

Qëllimi i rikultivimit i cili nënkupton që pas përfundimit të punëve në procesin teknologjik, sipërfaqeve të degraduara, prapë tu kthehet funksioni i saj primar, dhe kështu zvogëlohet ndikimi negativ i këtij projekti në ekosistem.

Planifikimi i shfrytëzimit të tokës, planifikohet që toka në lokacionin me reparacion të kthehet në gjendje të përafërt me ambientin rrethues.

9.1.1. Qëllimi i Rikultivimit

Qëllimi kryesor i rregullimit të hapësirës pas pushimit të aktivitetit të fabrikës është kthimi i kësaj zonë të degraduar në një zonë me një peizazh shumë rekreativ për komunitetin për rreth.

Në përgjithësi, zona do të paraqesë element me vlerë të lartë për mjedisin, në të cilin do të ekzistojnë në të njëjtën kohë shfrytëzimi bujqësor dhe vendbanimi për botën bimore dhe shtazore.

Krijimi i tokave antropogjenë në këtë zonë nënkupton ripërtëritjen e tokës së dëmtuar, harmonizimin e peizazhit, si dhe zgjerimin e kapacitetit të filtrit natyrorë të ajrit. Për rikultivim do të jetë e nevojshme shtresa pjellore e tokës dhe shtresa potenciale pjellore me përmbajtje agrokimike dhe mekanike. Sipas rregullave krijimi i biomasës me anë të rikultivimit në toka të degraduara ka për qëllim gjelbërimin dhe përmirësimin e kushteve të mjedisit të jashtëm konformë peizazhit rrethues.



9.1.2. Struktura përfundimtare e sipërfaqeve

Pas përfundimit të punimeve me rikultivimin teknik do të krijohet një profil i ri i tokës, e cila mund të përdoret edhe për nevoja tjera. Propozohet që rikultivimi në ngastrat ku është vendosur objekti i kompanisë të bëhet me mbjelljen e fidanëve të ngjashme me pyjet rrethuese, nëse nuk adaptohet për ndonjë aktivitet tjetër blegtorie psh. ngritje të ndonjë ferme ekologjike, ose edhe si toke pune apo kullosa, etje si alternativa të mundshme.

- Rikultivimi agroteknik dhe biologjik

Njëra prej detyrave me të rëndësishme në ngritjen e plantacioneve është zgjedhja e materialit fidanor dhe teknika e mbjelljes së fidanëve. Koha më e përshtatshme për mbjelljen e fidanëve fryt dhënësë është vjeshta, pasi që rrënja është aktive gjatë dimrit si dhe ekziston sasi optimale e lagështisë, kështu që bima në stinën e pranverës ka start me të suksesshëm. Para mbjelljes është mirë që toka të punohet në thellësi deri në 70 cm.

Për mbjellje duhet të hapën gropat të cilat duhet të jenë aq të mëdha sa sistemi rrënjor i fidanit të vendoset lirshëm në gropë ose shprehur në dimensione 60 x 60 cm gjerësi dhe deri 40 cm thellësi. Nëse nuk behët qeliza e tokës atëherë gropa duhet të hapet duke e ndarë dheun e shtresës së sipërme në njërën anë dhe pjesën tjetër në anën tjetër. Përgatitja e tokës është mirë të bëhet se paku një muaj ditë para mbjelljes.

- Përgatitja e fidanit

Përgatitja bëhet në atë mënyrë që 1/3 e rrënjëve prehen me gërshërë të mprehta në mënyrë që të iniciohet rritja e rrënjëve. Prerja duhet të shkaktoj plagë sa më të vogla.

Fidanët e përgatitura i fusim në një enë në të cilën është hedhur 50% bajaga, 50% argjilë (dhe i imtë) dhe një sasi uji.



Të gjitha këto përzihen deri sa të formohet masa e qulltë. Në këtë masë zhytet sistemi rrënjor i fidanit e pastaj fidanët shpërndahen nëpër gropa për mbjellje.

- *Mbjellja*

Mbjelljen e fidanit e bëjnë zakonisht dy punëtor. Njëri e mban fidanin, ndërsa tjetri e mbulon sistemin rrënjor të futur në gropë në atë mënyrë që sistemi rrënjor të shpërndahet njëlloj në të gjitha drejtimet. Në fund të gropës mund të vendoset edhe shkopinjtë e drurit në mënyrë që fidani të përforcohet. Në fund të gropës hidhet 150 gr. Pleh mineral NPK që shërben si ushqim e pastaj hidhet një sasi e dheut të imët në formë koni e pastaj vendoset sistemi rrënjor i fidanit.

Mbi rrënjë vendoset shtresa tjetër e dheut e cila me këmbë ngjeshët mirë e mirë. Mbi këtë shtresë vendosen 10-15 kg pleh organik, por duke mos pasur kontakt direkt me rrënjët. Mbi pleh vendoset prapë shtresë e dheut e cila ngjeshët mirë e mirë duke mos lënë ajër në mes rrënjëve dhe dheut.

Fidanët duhet të mbillen në atë thellësi në të cilën ka qenë në fidanishte. Fidanët përforcohen për hua duke i lidhur me shpagë në formë të numrit tetë dhe në të është e vendosur etiketa e llojit të fidanit. Rreth fidanit hidhet shtresa e mbetur e dheut duke i dhënë formën.

Nëse fidani është mbjellë në vjeshtë i jepet forma e humkës që të largohet uji i tepërt ose në formë të çinisë që të mbledh ujin gjatë verës.

Distancat e mbjelljes së fidanëve, Në skicë është paraqitur distanca e mbjelljeve që është 4 m rendi prej rendit, dhe 4 m bima prej bimës, drejtimi i mbjelljes është veri – jug, si ne fig ne vijim.




Figura 23. Shema e distancës së mbjelljes

Për të llogaritur numrin e fidanëve që do të mbillen përdoret formula

$$Nrf = \frac{S}{a \times b} = \frac{10.000}{4 \times 4} = 625 \text{ fidane/ha}$$

Nrf – numëri i fidanëve, S-sipërfaqja, a-distanca e fidanëve në rend, s-distanca në mes rendeve të shprehur në m.

Numri total i fidanëve të nevojshme për rikultivim në sipërfaqen 2 ha është 1250

Llojet e bimëve që do të mbjellën për krijimin e ekosistemit të ri

Fidanët frytdhënëse, si që janë: mollat e varieteteve të ndryshme, dardhat e varieteteve të ndryshme, kumbullat e varieteteve të ndryshme, qershitë e varieteteve të ndryshme, nektarinat e varieteteve të ndryshme mollët e varieteteve të ndryshme, etj.

Mirëmbajtjes së plantacionit të krijuar duhet kushtuar kujdes i veçantë sidomos në ujitje, prashitje, krasitje etj. Pas mbjelljes së fidanëve, pronari më tutje do të kujdeset për zhvillimin e tyre.

a. Rrethimi i plantacionit

Sipërfaqja e rikultivuar për të mbrojtur nga dëmtimet fizike duhet rrethuar menjëherë si të filloi mbjellja e bimëve. Për ta rrethuar këtë sipërfaqe më parë duhet



te vendosen shtyllat e çimentos ose drurit në distanca 3-4m, e pastaj në këto shtylla vendoset rrjeta e telit.

10. PËRFUNDIMI

Ndikimi i fabrikës së ujit të kompanisë Anahita Sh.p.k. në mjedis, duhet të jetë në nivelin e vlerave të rekomanduara me Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025, Ligjin për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181 dhe me ligjet dhe aktet nënligjore të aplikueshme.

Ndikimi në mjedisin tokësor do të jetë i vogël dhe si i tillë mundet të neglizhohet, kurse ndikimi në ajër dhe ujë mund të kontrollohet. Për të dy këto ndikime do të monitorohen dhe do të raportohet në fund të çdo viti kalendarik, dhe sipas kërkesës së Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktura.

Pas punimit të këtij raporti, mund të konkludohet se nuk ka potencial të rrezikimit të shëndetit të njerëzve, gjithashtu ndikimet në tokë, ujë, ajër dhe peizazh, pas identifikimit dhe zbatimit të gjitha masave mbrojtëse të rekomanduara në këtë raport, konstatohet se ato mund të zvogëlohen në nivel të lakmueshëm dhe atë nën vlerat kufitare të përcaktuara me legjislacionin vendor dhe të BE edhe të eliminohen tërësisht në fazën e rehabilitimit të hapësirave të degraduara gjatë ndërtimit dhe realizimit të projektit.



Referenca

1. Plani Zhvillimor Komunal i komunës së Istog;
2. Qavolli. R. (1997): Gjeografia regionale e Kosovës. Prishtinë;
3. MMPH (2013): Legjislacioni mjedisor në Kosovë 2007-2013 (Vëllimi I). Prishtinë;
4. B. Shehu dhe K. Karaxha, Hidrologji Inxhinjerike, 1996, Tirane;
5. K. Katundi, Furnizim me ujë dhe trajtimi i tyre, Tiranë;
6. MMPH-AKMM (2008): Raport i gjendjes së mjedisit 2006-2007. Prishtinë;
7. MMPH-AKMM -IKMN (2008): Raport i gjendjes së natyrës 2006-2007. Design House. Prishtinë;
8. MMPH-AMMK (2010): Gjendja e Natyrës-Raport 2008-2009. UNDP. IN Design. Prishtinë;
9. MMPH-IHMK – Buletini Hidro-Klimatologjik 2016;
10. MMPH_IHMK – Resurset Ujore te Kosovës 2015;
11. MMPH-IHMK – Vjetari Hidrometeorologjik 2014;
12. Te dhënat nga investitori i kompanisë Anahita Sh.p.k.;

Shtojca

- Certifikata e biznesit;
- Kopja e planit;
- Certifikata e pronësisë;
- Pëlqimi i komunës ;
- Leja ndërtimore nga komuna;
- Leje mjedisore komunale;
- Pëlqim nga AME;
- Pëlqim nga K.R.U. “DRINI I BARDHË” për kycje ne kanalin e ujit;
- Matjet gjeodezike;
- CD-raporti i VNM-së;